




AHMED HULUSI

ISLAMI





ISLAMI

AHMED HULUSI



www.ahmedhulusi.org

**ALLAHU im na bënë të ndërgjegjshëm mbi
njëmendësitë Tua ,
Na ndihmo t'i kuptojmë ato ,
Që t'i mësojmë
Sheshona rrugën
Në takimin e më të dashurve TU, në të dy botët !**

CONTENTS

NJËMEDEŠITË <<ISLAMIT>>-----	6
A KA <<DETYRIM>> NË ISLAM-----	10
Ç’FAR DO TË NDODHTE NËSE KA...? Ç’FAR DO TË NDODHTE NËSE NUK KA..?-----	16
A KA BARAZI..!-----	20
PËRSE PRAKTIKAT (IBADETI) NA JANË PROPOZUAR?-----	24
NUK KA <<ZOT>>! KA <<ALL’LLAH >>!-----	28
A MUND T’A SHENJOJMË <<ALL’LLAHUN>> ME <<ZOT>>?-----	32
KUSH ËSHTË I AUTORIZUAR N’EMËR T’ALL’LLAHUT OSE TË RELIGJIONIT?-----	36
UNË JAM PËR HILAFET(KALIFAT)-----	40
TË LIROHEMI NGA FSHIKËZA (GUASKA) E SË <<DJESHMES>> DHE T’A ARRIJMË QENËSINË-----	44
KUPTONIE <<ISLAMIN>> E JO <<ISLAMIZMIN>>-----	50
DALLIMI NDËRMJET <<ISLAMIZMIT>> DHE <<DIN AL- ISLAM>>-----	54
ISLAMIZMI MATERIALIST-----	58
UNË JAM NJË FUNDAMENTALIST-----	64
Ç’FAR KA LEXUAR MUHAMMEDI-----	68

<<LEXIMI SISTEMIT>> -----	72
<<DIN-I ISLAM>> SHPJEGON <<SISTEMIN>> -----	76
TRUNI DHE DHIKRI -----	80
DUAJA VALËT E DREJTUARA NGA TRUNI -----	84
SHPIRTRAT TONË A PASKAN QENË KRIJUAR NË TË KALUARËN? -----	88
RIINKARNIMI DHE NDËRHYRJA E <<EXHINËVE>> -----	92
SI ËSHTË JETA PAS VDEKJES -----	96
NE E KEMI SHNDËRRUAR <<RAHMETIN >> NË NJË ORTEK! -----	100
ÇËSHTJA E MBULESËS -----	106
CILI ËSHTË QËLLIMI JUAJ -----	110
A JEMI NE TË VETËDIJSHËM PËR KËTO FAKTE? -----	116
KËNAQËSIA E EGOS ME NDIHMËN E DOMINIMIT -----	122
JU I SHTYNI NJERËZIT TË MENDOJNË DUHET TË CENZUROHENI -----	126
FJALA IME E FUNDIT -----	130

1



NJËMEDËSITË <<ISLAMIT>>

6

*Secili prej nesh fiton pak a shumë një njohje fetare . Megjithatë një pjesë e madhe e kësaj njohjeje , ose ndoshta edhe e tëra , është fituar thjeshtë me një **po-të thënë(duke i dëgjuar të tjerët)**;pra kjo nuk është arritje e hulumtimeve tona vetjake. Në çfarë mase njohja jonë mbi <<**Islamizmin**>>mund të jetë realisht në pajtueshmëri me <<**Fenë Islame**>>burimore?*

*Nëse don ALL'LLAHU, gjatë këtij muaji të **Ramazanit** ne do t'ju paraqesim shpjegimet tona vetjake mbi <<**Fenë Islame**>>. Ju ndoshta do të mësoni për herë të parë , prandaj edhe , shumë nga këto (mësime)do të mund të ju habisin!*

*Tridhjetë e katër vite të studimit tonë mbi mënyrën e të kuptuarit të fillesave të Islamit , janë kurorëzuar me bindjen tonë se <<**Islamizmi i diskutuar përgjithësisht**>>dhe <<**Feja Islame**>> , në fakt janë dy çështje krejtësisht të ndryshme .*

Feja**, e tillë siç është mësuar në **Kur'anin e shenjt dhe përcjellur nga Pejgamberi Muhammed –paqja qoftë mbi te ,

*nuk pranon kurfar dykuptimësie; **nuk ka asnjë element , që një mendje e zgjuar do të mund t'a mohonte!***

Ndryshe, <<n'islamizëm>> , ka shumë gjëra që janë në kundërshtim me arsyetimet , me logjikën dhe me shkencën, që janë më shumë prodhim i shpjegimeve të gabuara të njerëzveqë e që fatkeqësisht i janë mvësh pa të drejt <<Fesë Islame>>.

*Në fakt janë dy grupe që flasin mbi<<Fenë Islame>>. Shumica prej tyre janë **ata** të cilët ende janë të burgosur në guaskat e tyre të <<**së djeshmes** >> . Ata pohojnë se feja është një besim që ndalon mendimin , arsyetimin dhe hulumtimin . Ka të tjerë që kanë dalë nga guaskat e tyre dhe hulumtojnë e mendojnë . **Ata përpiqen t'a kuptojnë <<Fenë Islame>>.***

7

Në këtë vepër ne ju paraqesim pasqyrimet tona mbi faktet si objekt i hulumtimit tonë vetanë .

*Koncepti i<<ALL'LLAHUT>>i tillë siç është shpjeguar **Kur'anin e shenjt** , ka një domethënie krejt tjetër nga koncepti i <<Zotit>>, të cilit i besojnë njerëzit e cilësdo fe qofshin .*

*Të gjitha rregullat e Islamit duke paraqitur shpjegimet mbi **ALL'LLAHUN** I Cili krijoi **SISTEMIN** në të cilin jetojmë , dhe i drejtohet njerëzimit , nuk janë urdhëra të një Zoti atje tej, të cilin do të duhej t'a kënaqim .*

Shumica nga çështjet e përmendura në<<Fenë Islame>>janë mbështetur mbi një logjikë dhe mbi parimet e vërtetuara me shkencën bashkohëse ; ne do të punojmë me zell që t'i shpjegojmë gjatë këtij muaji të Ramazanit.

*Duke qenë se asnjë qenje në këtë botë , nuk ka pushtet të flas , të predikojë ose të gjykojë **N'EMËR të ALL'LLAHUT** aq më pak të deklarohet Pejgamber, - asnjëri nuk ka aftësi*

(ligjore)t'a gjykojë akcilin **NË VEND TË ALL'LLAHUT**. Askush nuk ka të drejtë .

Secili ka për t'i hequr(vuajtur) pasojat e asaj që ka punuar(vepruar) , dhe kjo në përpjestim me shkallën e respektimit të rregullave të SISTEMIT Në të cilin jetonte !

Prandaj , qenjet njerëzore shpejt duhet t'a jetësojnë dhe t'a kuptojnë realitetin e jetës , në mënyrë që të veprojnë asisoi që të mos ken hidhërim në jetën e pas vdekjes .

Gjithçka , në Kur'ANIN E SHENJT , ka një shpjegim, një fthillim i mbështetur në shkencë , arsyetim dhe logjikë , sepse shpjegon SISTEMIN , Rendin që e ka krijuar ALL'LLAHU .

Nëse ne mbetemi të paknaqur , nganjëherë , kur përpigemi t'i shpjegojmë disa pika të **SISTEMIT** , kjo ndodhë sepse i shpëtojnë të kuptuarit tonë, dhe se ne ishim të paafte t'i kuptojmë (kapim)me mendje .

Në këtë kapitull, të përpigemi para së gjithash t'a qartësojmë një çështje

Praktikat e urdhëruara(porositura) me Kur'ani Kerimin , që n'a i ka përcjellë Pejgamberi Muhammed , paqja qoftë mbi te, nuk janë një <<pako>> e ngjeshur ; më shumë janë vepra që secili mund t'i përmbush aq sa mundet . Secili do të shpërblehet sipas shkallës së respektimit të këtyre praktikave , njësoj sikur që edhe do t'i heq pasojat e pakëndshme për çdo shpërfillje!

Të mendojmë se nuk do të kini pengesa që të agjëroni për shembull , mirëpo ju nuk mund t'a kryeni namazin tuaj(për një arsye ose tjetër)..Kurrë mos mendoni se meqë ju nuk e kryeni **Namazin** tuaj ju nuk duhet të agjëroni ; sidomos mos iu bindni

kurrë atyre që ju thonë këtë . Kryeni atë që mundeni nga obligimet praktike !

A nuk do të ndërhyshit ju , pasi të keni vërejtur se ka shpërthyer zjarri në një kënd të shtëpis suaj? A nuk do të përpiqeshit të shpëtoni nga zjarri sa më shumë që kjo do t'ishte e mundur ? Po kështu përpiquni që ju të fitoni nga praktikat tuaja , sa më shumë që të mundeni , gjatë ditës suaj, sepse jeta kalon shpejt !

Nëse ju jini një grua dhe ju nuk mund të mbuloheni për një ose një tjetër arsye , a do të ju pengonte kjo t'i respektoni praktikat tjera , si agjërimi(Ramazanit), namazi ose Haxhi ! Sepse mbulesa, namazi dhe Haxhi janë krejtësisht detyra të ndryshme .

9

*Të kujtojmë ne gjithmonë se porosit e Kur'ani Kerimit nuk janë pako e ngjeshur programesh . Secili mund të praktikojë aq sa mundet ! **Kuptohet se është e pëlqyeshme që të zbatohen të gjitha . Qoftë bekuar Ai që vepron kështu !***

Tema jonë vijuese do të jetë gjymtësia e SHTRËNGIMIT (shtypja , përdorimi i forcës) n'Islam si edhe arsyet

* * *

2



A KA <<DETYRIM>> NË ISLAM

10

*Në një artikull botuar në gazetën <<Hyrrijet>> të së Premtes 15 Dhjetorin e kaluar, Mr.Oktai Eksi, Drejtor i Përgjithshëm i Shtypit tyrk pohonte se ka pas detyrim në **Fenë Islame**, duke iu drejtuar një shkrimi të burimit në vazhdim :*

*Burimi : gazeta “Yeni Gündem”, N°43, f.16-17, shkruar nga Abduhahman Dilipak : <<**A mund t’i kënaq Islami nevojat e epokës sonë?**>>, Server Tanilli, f.210.*

<<Ne nuk mund t’a interpretojmë islamin përmes demokracisë, liberalizmit racionalizmit. Islami nuk është demokrat aq sa nuk është edhe racionalist. Islami ka vlerat dhe masat e saja vetanake. Nuk ka detyrim në fe, por n’Islam ka. Nëse një individ përqafton fenë muslimane, ai(ajo) do të dënohet, nëse nuk i përmbahet rregullave të saj. Për shembull një grua muslimane nuk mund të dalë kokëzbuluar. Ajo do të ndëshkohet nëse del pa mbulesë! Një individ që konsiderohet muslim nuk mund të haj gjatë orarit të agjërimit. Çdo fëmij mund të heq dorë nga feja deri në moshën 18 vjeç (mosha e miturisë). Mirëpo nëse ky e bën këtë pas kësaj moshe do të vritet.....>>

Ne mendojmë se gabimi më i rëndë i zotri Eksi, i cili kritikon <<**Fenë Islame**>>, ose një cilido qoftë autor tjetër që do të reagonte kështu, është pasojë e mosnjohjes së bazave të <<**Fesë Islame**>> përmes vlerave dhe rregullave të saja burimore, dhe një njohje e kufizuar, e mbështetur vetëm në të dëgjua përanash (andej-kënde), në tha e thash!

Kur t'i drejtohem Librit bazë t'Isllamit, <<**Nuk ka detyrim në kryerjen e obligimeve –detyrave të fesë**>>. Termi <<**la ikrah**>> (kurfar detyrimi) në ajetin kur'anor shoqëruar termit <<**fi-ddin**>> (në fe) kanë të bëjnë me **PRAKTIKAT e FESË**. Të shtrembërohet ky fakt dhe të pohohet se një individ është i obliguar t'a pranojë një Fe nën presion, vë në dukje paaftësinë për t'a kuptuar <<**SISTEMIN**>> brenda Fesë.

11

Sipas **Kur'anit**, asnjëri nuk mund të detyrohet në fe, kjo do të thotë që asnjëri nuk mund të shtyhet t'i ndjekë praktikën fetare!

Arsyet.....?

Në <<**Fenë Islame**>>, tiparet kryesore që kërkohen nga krijesat njerëzore janë : sinqeriteti, **ihlas**, **ndershmëria e brendshme**, në mënyrë që tërë atë që e kryejnë, të jetë ky jetësim i vërtetë i bindjes së tyre intime. Kurrë nuk duhet që besimtarët të veprojnë me krekosje, që të duken sheshazi, por duhet t'ju shmangen **hipokrizisë**.

Gjëja e parë të cilën **Islami** e qorton është **hipokrizia (nifâk)**, që do të thotë fakti të bësh një sjellje të jashtme që është në kundërshtim të plotë me të brendshmen (shpirtëroren) tënde, në një qëllim të keq çfardoqoftë ai. Me fjalë të tjera **nëse ju nuk keni një bindje të brendshme të fortë, fakti se ju zbatoni, namazin tuaj, të agjëroni, ose të mbulonit kokën me një shami, nën ndikimin e presionit, n'asnjë mënyrë nuk ju bëjnë**

besimtar. Përkundrazi, kjo do të ju shndëronte në munafik, që do të thotë në hipokrit.

Nëse një individ ka të paktën besimin(imanin), mirëpo nuk është i zoti t'i përmbush disa praktika, ai nuk konsiderohet si mosbesimtar. Ndryshe, nëse ne e obligojmë këtë individ me forcë t'i kryej disa nga praktikat(ibadetet), të cilat e neverisin atë, ne do t'a shpienim atë kah hipokrizia(nifak)dhe ne do të mbanim përgjegjësi për sjelljet e tij. Sepse, duke vepruar kështu, ne në një mënyrë do t'a shndërojshim një besimtar në mosbesimtar (munafik), duke e larguar nga besimi tij dhe kështu ne do të mbanim përgjegjësinë.

Së këndejmi, ashtu siç përmendet në Kur'an,<< **NUK KA DETYRIM NË ZBATIMIN E PRAKTIKAVE FETARE**>>. Ai i cili e kupton **SISTEMIN** e <<**Fesë Islame** nuk ushtron kurrë presion mbi të tjerët.

12

Ata të cilët kritikojnë ose komentojnë Islamin para së gjithash duhet t'i kenë parasysh këto pika :

Sipas parimeve themelore të << **Fesë Islame** >>por jo sipas rregullave joserioze (tekash) të shpikuara më vonë nga të tjerë, asnjë nga udhëzimet e Kur'anit nuk është detyrues ; të gjitha i janë lënë zgjidhjes së lirë që secili t'i zbatojë ashtu siç i ndjenë, gjatë jetës së kësobotshme, dhe si kundërshpërblim do të mblidhte frutet në jetën e pasvdekjes.

Kjo botë –këtu është një vend i rezervuar për praktika(ibadete), ndërkaq tjetra, kjo e pasvdekjes është një vend ku ne do të gjejmë dënimin për veprat e jetës sonë të parë.

Shikoni se si interpretuesi i shkëlqyer, Hamdi Yazir Elmali, e ka shpjeguar n'interpretimin e Kur'anit në turqisht, të titulluar <<**Hak Dini Kur'an Dili**>>, <<**Feja e së Vërtetës gjuha e**

Kur'anit>>, që nuk kishte detyrim, zor-shtrëngesë(**ikrah**) në <<**Fenë e Islamit**>>dhe se detyrimi dhe përdorimi i forcës janë në mospajtim me Fenë :

<<**Ajo që është me rëndësi në Fe është qëllimi juaj e jo veprimi juaj me forcë. Prandaj, detyrimi(ikrah)që shtyn individin të veproj nën shtytjen e forcës, është e qortuar dhe e ndaluar.**

Mund të ketë detyrim(ikrah) në gjithësi por jo kurrë në Fe. Respektueshmëria(fisnikëria-dinjiteti) e Fesë nuk lejon detyrim(shtrëngesë-zor), ajo për ma tepër e ndalon ate.

Prandaj, kudo ku është vendos njëmendësisht Feja Islame , nuk ka kurfar detyrimi. Kurrë nuk duhet pasur mbrojtjen e forcës. Po u bë kjo, atëherë kjo është shkelje e Fesë.

Nuk do të ketë shpërblim të premtuar me Fe për një punë të kryer me zor (ose i detyruar)dhe asnjë praktikë –ibadet, nuk mund të konsiderohet si e tillë, nëse nuk shoqërohet me një qëllim të mirë dhe me një bindje të thellë!

Veprat qëndrojnë në lidhje të ngusht me qëllimet! Ne, me vet dëshirën tonë dhe me zell, duhet t'i përshtatemi kërkesave të Fesë.

Imponimi i besimit me forcë është një pamundësi. Namazi i kryer, përkundër nesh, nuk është një lutje më shumë, jo më shumë sa nuk janë edhe agjërimi dhe shkuarja në haxh etj të kryera në të njejtat kushte.

Për më tepër, nuk i lejohet asnjëriut t'i përdhos të drejtat e akcilit ose t'a shtyej të bëj çfardoqoftë. Të konkludojmë, n'Islam, secili duhet të përmbush detyrën e vet sipas qëllimit vet, pa kurfar DETYRIMI(ZORI). (Vëllimi:2, f.860-861).

Kjo është arsyeja për të cilën asnjëri nuk ka as të drejtë e as detyrë t'ja imponojë obligimet fetare (praktikat religjioze) me forcë! Ata që e bëjnë këtë e përdorin fenë si një instrument në shërbim të interesave të tyre vetjake, duke keqpërdorë autoritetin ndaj njerëzve, një sjellje e tillë është në kundërshtim të plotë me <<Fenë Islame>>.

Që t'a njohim më mirë, të shofim shpejt mbi çështjen e poshtshënuar me sa vijon...<<Feja Islame >> paralajmëron jetën pas vdekjes.

Ç'far do t'i ndodhë nëse ka? Ç'far do t'i ndodhë nëse nuk ka?

Nesër, insha'ALLAH!

* * *

3



Ç'FAR DO TË NDODHTE NËSE KA...? Ç'FAR DO TË NDODHTE NËSE NUK KA..?

16

Një ditë, Mbreti i Miqësisë hyjnore dhe Dera e shkencës, Hazreti Aliu, këmbëu mendime me një mosbesimtar, i cili nuk qe bindur mbi njëmendësinë e jetës së pas vdekjes... Ata ishin angazhuar në një bashkëbisedim të këtillë:

<<Ç'farë do të ndodh nëse nuk ka jetë pas vdekjes? Të gjitha praktikat (ibadetet) tuaja si Namazi dhe Ramazani a thua nuk do të shkojnë huq?>>.

Në këtë pyetje Hazreti Aliu i përgjigjet :

<< Po ç'far do të ndodh nëse jeta pas vdekjes vazhdon? Ç'far do të ndodh me ty, meqë ti nuk je përgatitur për një rreth të tillë? Edhe sikur të mos kishte jetë pas vdekjes, të këtillë çfar ti e sygjeron, unë nuk do të humbsha asgjë nga kryerja e këtyre obligimeve. Mirëpo nëse jeta pas vdekjes vazhdon ashtu siç e besoj, atëherë sigurisht që do t'isha unë ai që do të shpërblehesha! Mirëpo ti, nuk do të mund t'i shpëtojshe dënimit dhe do t'ishe një i mjerë, i humbur përgjithmonë,

meqë ti nuk e ke llogaritur ekzistencën e një jete të tillë dhe ti nuk e ke kryer detyrën tënde...!>>.

*Një njeri i cekët (mendjelehtë) mund t'i shtrohet një çfardo rreziku për një gëzim jetshkurtërose një kënaqësi të çastit. Mirëpo vuajtja e një humbjeje zgjatë për aq kohë sa të jetojë individi. Sidoqoftë dhembja e një humbjeje të tillë, që është nga më të rëndat përfundon **(zhduket)** me kohën.....Megjithatë, së paku është e palogjikshme që njeriu, të jetë aq torollak(i trashë nga mendja) që të rrezikojë t'a shkatërrojë jetën e vet t'ardhme, të përherëshme, të pas vdekjes, për një kënaqësi të përkohshme- jetëshkurtër të kësobotshme, duke thënë i hamendur << **se ndoshta nuk ka (jetë përtej varit)...**!>>.*

17

*Poashtu është po aq e paarsyeshme kjo ide : <<**ne do t'i pësojmë së pari sprovat e vdekjes e pastaj do të marrim masa, nëse jeta do të vazhdon atje!**>> Ky është një mendim që ka të bëjë me marrëzit e njerëzimit!*

Pejgamberi i ALL'LLAHUT shpjegon:

<<Nuk mbetet asgjë për të zbatuar pasi t'a kini kërkuar vdekjen! Secili ka rast të kryej detyrat e veta vetëm gjatë jetës së vet në këtë botë. Porositë(Këshillat), përfshirë edhe Namazin, Ramazanin, Haxhin dhe praktikat tjera janë të vlefshme, vetëm nëse ato janë kryer gjatë jetës së kësobotshme. Në jetën e pasvdekjes do të jetë e pamundur të pastrohesh nga gabimet me zbatimin e po këtyre këshillave,(të sipërpërmendura)!>>

*Nëse të gjitha këto praktika janë kryer në këtë botë dhe janë deponuar në shpirt përmes trunit, ato do të veprojnë pastaj duke qenë forcë shpirtërore e dobishme, në jetën e pasvdekjes. **Pas zhdukjes së fizikut dhe trunit(mendjes),***

asnjë nga ibadetet(praktikat) nuk mund të deponohet në mendje, e as.që mund të kihet ndonjë përfitim.

Prandaj , nuk ka gabim më të rënd se sa ideja:<< vdis njëherë, që të mund të shohish nëse ka një tjetër jetë atje, që të mund të përgatitesh >>.

Është një epërsi e madhe për njeriun, si qenje njerëzore, të jetë i zoti t'a studiojë thellë <<**Fenë Islame**>>, t'a kuptojë **SISTEMIN e Rendit**, ashtu siç i kanë shpjeguar dhe të jetësojë gjithanshmërin e fakteve të përmendura. Një përkapje e tillë do të shpiente kah një perspektivë krejt e re e vet jetës së njeriut, e cila do t'jupte fund të gjitha spekulimeve mbi kuptimin e jetës dhe vlerat e saj në kuadër të njëmendësive të pasvdekjes.

18

Ndryshe, moskuptimi i <<**Fesë Islame** >>, **Sistemit dhe Rendit**, do të na shpiente drejt një interpretimi të keq gjatë gjithë jetës sonë, dhe kështu ne do t'iknim(nga kjo botë) pa kurfar përgatitje në jetën e pasvdekjes. Aq më tepër ne do të humbim jetën tonë me teoritë e një zoti hyjnor, pa mos e njohur njëmendësinë (realitetin) e **ALL'LLAHUT në Qenësinë tonë**, dhe ne do t'a jetojmë historinë tragjike të këtij (kësaj)që do të mbetej në një gjendje përgjithmonë e mjegulluar (mbuluar).

Një periudhë shtatëdhjetëvjeçare duket si e gjatë....krahasuar me vitet në tokë. Orbita diellore përreth qendrës së galaksisë kap 255 milionë vjetë. Sapo ne t'arrijmë në mbretërinë e jetës së pas vdekjes (**ahiret**) dhe sapo të zhduket bota fizike, ne do të jetojmë në një përmasë tjetër diellore ku jeta tokësore do të na duket të ket zgjatur vetëm 8, 6 sekonda....

Kështu paraqitet jeta e individit : nga njera anë, **një jetë prej 8.6 sekondash** e cila është e barazvlershme **me 70 vjetë**

jetese mbi tokë, n'anën tjetër një përmasë tjetër e jetës e cila ju pret dhe e cila duhet të zgjasë **miliarda vite....**

Nëse ju ende nuk e kuptoni këtë, jetën e përhershme të **pasvdekjes**, mirëpo doni që vet me duart tuaja t'a shkatëroni jetën tuaj, jetë e cila zgjatë përjetësisht, s'ka dyshim se ju jini të lirë që t'a shndërroni ate në Fer -Xhehenem.... Sigurisht që kjo është e drejta juaj!

ALL'LLAHU nuk shtyp robërit e vet.

Njerëzit përfitojnë ose vuajnë nga rezultatet e zgjidhjeve të tyre.

Vlerësimi i <<**Fesë Islame**>>përmes <<**Islamizmit**>>,(t'i shoqërohet <<**Feja Islame**>> <<**Islamizmit**>>) kushton shtrenjt...

Ne seriozisht duhet të bëjmë nga **SISTEMI** një udhëndjekjeje të jetës sonë....

A jemi ne të barabartë

* * *

4



A KA BARAZI..!

20

Tash, shikoni mirë përgjigjet tuaja në pyetjet vijuese...

*A mos kini marr ju far vendimin në ekzistencën (lindjen)tuaj në një yllësi të quajtur **Kashta e Kumtrit**, midis miliada yllësish tjera, sipas të dhënave të fundit shkencore? A mos ishte kjo dëshirë e juaja?*

*A mos ishte vendimi ose zgjidhja juaj që të vini në botë në **një sistem diellor** midis një mase prej 400miliard yjesh, e njohur si **Yllësia e Kashtës së Kumtrit**, që ndodhet në një largësi **32mijë vjetë drite**, po kështu sipas të dhënave shkencore?*

*A mos e kini zgjedhur ju poashtu të lindni **homo-sapiens**, në një planetë të quajtur **tokë**, të një madhësie **303mijë herë më e vogël** se kjo e diellit?*

Mos është zgjidhja juaj edhe përkatësia kontinentit, të cilit i takoni, vendit tuaj, racës, përkatësia kombëtare dhe brezi të cilit i takoni?

A i kini zgjidhur ju prindërit tuaj, mjedisin dhe kushtet familjare, a jini këshilluar ju për çdonjerën prej tyre?

Ju ndoshta do t'a zgjidhshin gjinin tuaj mashkullore ose femrore në këtë botë?

Lidhur me këtë, shtrojmë pyetjet vijuese :

A mund t'a gjykojmë në një njeri, t'a dënojmë ose t'a urejmë ; a mund të bëjmë ndasi, t'i akuzojmë njerëzit për gjërat jashtë vullnetit tyre?

A mund të bëjmë ndasi në mes njerëzve, mbi baza të veçorive të tyre vetjake të prejardhjes, si raca, ngjyra, përkatësia fetare dhe gjuha, që janë përvetësuar në një mënyrë fare të rëndomtë në mjedisin e tyre?

21

A është kjo e arsyeshme, a është e drejtë? A është kjo në pajtim me drejtësinë dhe ndërgjegjen?

*Të ushtrosh një shtypje mbi njerëzit duke u mbështetur në parametra të tillë, bie ndesh jo vetëm me <<Fenë Islame>> por edhe me ndërgjegjen njerëzore dhe me logjikën, **sipas së cilës <<askush nuk mund të ndihet përgjegjës për tejkalim kompetencash >>. Nëse ekziston një pikpamje e tillë e gabuar, kjo duhet të rishqyrtohet!***

Sa i përket <<barazis>> në luftën tonë për jetën, së pari do të duhej të flitej mbi kushtet e barabarta, që e tërë gara të fillojë në mënyrë të paanshme. A thua ne i nisim njëmendësisht luftërat tona për jetën në rrethana të njejta?

Ju jini lindur nga një baba gjenial, nga një nënë e urtë, dhe genet tuaja janë plot shkencë dhe kulturë ; megjithatë, ndodhë që unë të jem i lindur gjenetiki i varfër, nga një çift i mjerë naiv, shpirtdëlirë, dhe ja që mjetet e jetesës nuk mundësojnë t'a shtypin dita ditën.

Ju jeni i lindur në një familje të pasur, dhe mund t'a hani kaftjallin në Nju-York dhe darkën në Tokio ; megjithatë,

ndodhë që unë t'i kalojë ditët me prindët e mij të mjerë, që mbajnë këpucë të ndrequra, dhe për të cilët një shetitje me automobil është luks!

Ju jini fëmiju i gruas dhe burrit më të bukur të botës, por unë, jam vetëm fëmiju i një nëne të tillë si Nasradin Hoxha, të cilit i thonë <<hiqmu prej rrugel!>>dhe të një babe të ngjashëm.

Ju jini pasardhës të dy Zotrinjëve të botës, por unë rrjedhë vetëm nga Mulla Kasimi...

Megjithatë, ne të gjithë jemi të barabartë!

*A jemi ne njëmend të barabartë? A marrim pjesë në luftën për jetën në rrethana të **njejta**?*

22

*Në kushte të njejta a mjekohemi ne në mënyrë të "**barabartë**"?*

*A ndahemi ne nga kjo botë ne në mënyrën të "**BARABARTË**" pas gjithë këtyre "**barazive**"...!*

*Ç'far **BARAZIE** atëherë...!*

***ADALET(DREJTËSI)**! Qoftë mëshira e **ALL'LLAHUT** mbi rahmetlin nënën time, e cila mbante po këtë emër dhe është varosur në **Stamboll**!*

*<< **ALL'LLAHU**>>, të **CILIT** askush nuk i ngjanë, paralajmëron :<< **BËJ ATE QË DUA**>>!*

*Nga ana tjetër unë dhe të gjithë njerëzit në botë, nuk jemi <<asgjë >> në krahasim me "**ALLAHUN** ", njohja, fuqia dhe krijueshmëria e të **CILIT** është e pakrahasueshme (paarritshme), poashtu ne mvaremi plotësisht nga dekreti **TIJ**, autoriteti **TIJ**, dhe nga vullneti **TIJ** dhe se ne nuk mund të kemi asgjë, nga ajo që nuk n'a është dhënë prej **Vet-ATIJ**.*

DREJTËSI (Adalet) është një emër dhënë ATIJ që ua pranon krijesave njerëzore atë që don AI, sipas meritës tyre!

Jeta në këtë botëështë ajo ku zotrojnë pamëshirshëm të hollat dhe titujt...Një gazelë në kthetrat dhe dhëmbët e luanit; një qinq, një pulë në dhëmbët e njeriut dhe të varfërit nën mëshirën e të pasurve!

<<Feja Islame>> e kumtuar nga Pejgamberi Muhammed, që mbështetet në një **SISTEM** dhe Rend të përgjithshëm, na njofton mbi realitetin e jetës pas vdekjes ku secili do të shpërblehet sipas veprave të veta.

23

A nuk do t'ishte më mirë tash, të përfundojmë me tërë atë që ka kaluar dhe t'a çmojmë jetën tonë në dritën e asaj që mund t'a kryejmë....?

A thua do t'a konsiderojmë ne më në fund këtë seriozisht?

Përse dhe për kënd ne kemi nevoj t'i respektojmë praktikat religjioze?

* * *

5



PËRSE PRAKTIKAT (IBADETI) NA JANË PROPOZUAR?

24

Sigurisht në mendjet e të gjithë neve, që në vitet e para, n'a është ngulitur ideja se :

<<ALL'LLAHU nuk ka nevoj për namazet tuaja! Tërë ate që bëni ju, është për vet ju!>>

*Kjo thënje e thjeshtë ç'është e vërteta tregon një fakt themelor që ka të bëjë me Rendin, **SISTEMIN E ALL'LLAHUT** siç e shpjegon <<**Feja Islame**>>. Qëllimi ishte të thjeshtohet një fakt për një të kuptuar sa më të mirë. Sidoqoftë ne nuk e kemi sendërtuar këtë fakt.*

Nëse ALL'LLAHU nuk ka nevojë për praktikat (ibadetet) tona, përse atëherë ne duhet t'i kryejme ato? Përse ne kemi nevojë të falemi?

Cili është qëllimi Namazit agjërimi i Ramazanit, shkuarja në Haxh dhe ibadetet tjera?

Dijeni se kjo është ndër çështjet shumë të rëndësishme që të gjithë duhet t'a kuptojmë mirë!

Për shkak t'informit të keq(njohjes së cekët-dobët)ne kemi përfytyruar se duhet t'i kryejmë praktikat - obligimet(ibadetet)fetare me qëllim që të kënaqim dëshirën e një Zoti hyjnor, që qëndron diku mbi një yll, që të fitojmë dashamirsitë e TIJ dhe do të na pranonte në Parajsën e TIJ ose do të na gjuante në Fer!

Sidoqoftë, nuk ka zot, që ndodhet diku largë, që do të na provonte (merrte në provim)dhe do të na hidhte në Fer pas testit, as ky i cili do të na pranonte në Parajsën e vet pasi t'a kemi fituar besimin e tij.

Të kujtojmë tash se gjëja e parë që n'a mëson <<ISLAMI>> është<<dëshmia e Njësisë>> (kelimej Tewid>>, kuptimin e njëmend të së cilës ne nuk e dijme.

Kemi synuar se <<ALL'LLAHU>> është i vetmi zot për t'u adhuruar, meqë pohimi <<La ilahe illa 'ALL'LLAH >> qe përkthyer me << nuk ka zot për t'adhuruar vetëm ALL'LLAHU(është)>>, pa asnjë shqyrtim serioz dhe pa asnjë shqyrtim të vëmendshëm (arsye) të pasojave të mëtejme.

Kuptimi i njëmendtë i pohimit të Njësisë është megjithatë ky këtu :

<< Nuk ka zot, (ka) vetëm ALL'LLAH>>.

Atë që Pejgamberi Muhammed a.s. është përpjekur t'a sendërtojë, është fakti në vijim :

*Nuk ka zot për t'adhuruar ose diçka për të marr prej tij.Tërë ideja e zotit është paturpësi (fyese), duke qenë se **Vetëm ALL'LLAH ka....**Ja kjo këtu, është ideja kyqe prej së cilës janë frymëzuar të gjithë **Sufitë**,(dhe në saje të së cilës kanë arritur shkallën e tyre të lartë shpirtërore). që të gjithë **që nga***

Mewlana Xhelaludin deri tek Haxhi Bektash Wali, nga Imam Xhafar al Sadik tek Abdylkadër Xhejlani....

Njerëzit e së Vërtetës (**hakikat**) janë liruar nga ideja sipas së cilës <<**ALL'LLAHU**>> ishte menduar të jetë një zot larg, jasht vet-atyre ; kanë jetësuar se të gjitha gjërat ekzistojnë sipas vendimit **t'ALL'LLAHUT**, përmes **Vet Emrave të TIJ (Esma yl-husna)**. Ata e dijnë se dashuria dhe shërbimi që i bëhen krijesave, në fakt i janë dedikuar Krijuesit. Ja në këtë kuptim shërbimi i bërë njerëzve në fakt është shërbimi që i bëhet **Hakut (Të Vërtetit)**.

Meqë <<**ALL'LLAHU**>> ka krijuar gjithçka me vendimin e TIJ, përmes Emrave të **TIJ (Esma yl hysna)**, të gjitha ligjet dhe rendi i natyrshëm në këtë botë tonën, janë në fakt **Sistem, Urdhër i ALL'LLAHUT**. Së këndejmi, ne duhet të jemi të vetëdijshëm mbi faktin se sa me shumë që e njohim **SISTEMIN, Rendin** ku jetojmë aq më shumë ne do t'a kuptojmë urdhërin (vendimin)**eALL'LLAHUT**.

26

Është <<ALL'LLAHU >> AI që krijoi, që nga përjetësia pa fillim, **Sistemin, rendin**, ku po jetojmë ne.

Kush qëndron në zanafillën e formimit të tij, kushteve të tij, dhe Kush na e bëri në vazhdim të arritshëm Kumbin (Shpalljen) me ndërmjetësimin e Pejgamberve të Vet, duke n'a e bërë të ditur se çka do të fitojmë si kundërshpërblim për veprat tona!

N'a janë ofruar dy shtigje për t'a evituar pendimin e vonë në jetën e ardhme :

1.T'a qojmë një jetë të mbështetur në të kuptuarit e plotë të Këshillës së Pejgamberit dhe respektimin e tij në të gjitha marrëdhëniet! ose.....

2. Të përgatisim t'ardhmen tonë, duke ndjekur verbtas mësimet e Pejgamberit pa e kuptuar urtësinë që përmbajnë ato...

Tash ne duhet të vetëdijësohemi mbi faktim se asnjë praktikë (ibadet), këshilluar sipas <<Fesë Islame>> nuk i drejtohet një zoti ndodhur diku për të fituar mirësitë e tij. Përkundrazi, të gjitha janë praktika (ibadete) që lypsen përmes Sistemit të krijuar nga <<ALL'LLAHU>>.

Sikur ushqimet që i hamë për t'i kënaqur nevojat e trupit tonë (fizikut tonë) dhe jo të një zoti, praktikat (ibadetet), janë dedikuar në forcimin e mendjes, përgatitjen e jetës pas vdekjes, dhe shtimin e aftësisë së trunit, sa më mirë që ne të mundemi. Ne ose do të përgatitemi për kushtet e jetës së pas vdekjes me ndihmën e ibadetit (të obligueshëm) ose nuk do t'i kushtojmë kurrfar rëndësie dhe do t'i vuajmë pasojat.

Pa dyshim, se duhet t'a kuptojmë gjithsesi marrëzin e tërë konceptit të <<ZOTIT>> gjatë jetës sonë.....kjo është tema jonë në vazhdim!

* * *

6



NUK KA <<ZOT>>! KA <<ALL'LLAH >>!

28

Dhikri, siç thuhet rëndom, është zbatuar për të fituar të mirat e një zoti, atje diku jasht, duke i përsëritur emrat e tij!....

A është njëmend kështu?

Që t'akuptojmë këtë si duhet, para së gjithash duhet të sqarojmë, <<se çka dhe kë emërton<<qenja e përmendur >>....?

A do t'a zbatojmë ne dhikrin (përsiatjen)e një <<ZOTI>> ose <<ALL'LLAHUT>>! Shumica e lexuesve rëndom do t'a shtrojnë pyetjen vijuese :

<<Ku qëndron dallimi? E quajtet <<ZOT>> ose <<ALL'LLAH>>, është njësoj!Ne të tjerët Perëndimorët e kemi emërtuar ZOT! ZOTI është i madh!...

Jo! Zoti nuk është i madh! jo më i madh seç nuk ekziston! Tërë koncepti i Zotit është marrëzi!

*Kush e ka thënë këtë? Ja që kjo është thënë në << **FENË ISLAME**>> në Librin e tij të Shejnt, Kur'ani- Kerimin, që e*

shpjegon Islamin. **Resul ALLAHU-Muhammed Mustafaja alejhiselam**, Pejgamberi i ALL'LLAHUT e ka thënë këtë!

Ne jemi përpjekur t'a vëmë në dukje, në mënyrë të qartë dhe të sigurt e në hollësi, pra dallimin që qëndron ndërmjet konceptit <<ALL'LLAH>> dhe një koncepti krejt tjetër, të një <<Zoti>>në librin tonë titulluar <<MISTERET E NJERIUT>>dhe në librin <<ALL'LLAHU i Lajmëruar nga Muhammedi>>, poashtu ne jemi përpjekur t'a shpjegojmë <<FENË ISLAME>> mbi bazën e konceptit <<t'ALL'LLAHUT>>.

Asnjëri nuk mund të kuptoj se ç'është <<FEJA ISLAME>> dhe pse është paraqitur, nëse nuk e kupton krejtësisht dallimin që ekziston ndërmjet konceptit<<zot>> dhe emrit<<ALL'LLAH>>. Sepse duke shpërfillur këtë dallim, ai do të vazhdon t'a keqinterpretojë Fenë! Për më tepër nuk do të mund t'a kuptojë kurrë arsyen pse u është këshilluar njerëzve ibadeti-kryerja e obligimeve Islame!

Prandaj, ne para së gjithash, duhet t'a kuptojmë mirë dallimin ndërmjet fjalës <<zot>> dhe emrit <<ALL'LLAH>>, çfar kanë për premisë logjike.

Ç'far sygjeron emri <<Zot>>?

Emri <<Zot>> sygjeron një qenje largë jush, largë vet jush dhe largë gjithë ekzistencës, që ka krijuar gjithçka nga jasht, që n'a vështron nga jasht dhe i cili pasi të na ket gjykuar do të na hedh në Fer ose do të na pranonte në Parajs!...

Shumë njerëz, përfshirë edhe të gjithë zyrtarët fetar, të cilët pasi që i kanë lexuar pikë për pikë **Shkrimet Fetare** dhe nuk kanë arritur të shofim përtej

analogjis, besojnë me siguri në një <<zot>>, duke e mbrojtur << këtë zot>>dhe duke u përpjekur t'u imponohen njerëzve n'emër<< të këtij zoti>>!

Intelektualët dhe të gjithë të zotët e mendjes, nuk i besojnë një zoti të tillë, pasi që e kanë kuptuar se nuk mund të ketë diç ngjashëm ; prandaj dhe nuk ua vënë veshin zyrtarve fetarë.

*Megjithatë, të gjithë **Sufitë dhe Ewliat (Muslimanët e shejntë)**gjithnjë kanë përmbajtur idenë se studimi i <<Fesë>>duhet të bëhet mbi bazën e konceptit<< **t'ALL'LLAHUT**>>. Fatkeqësisht, janë të pakët këta njerëz!*

*Sipas Kur'ani Kerimit, që e shpjegon një njëmendësi tillë<<**ALL'LLAHU**>> krijoi gjithësitë(universet) dhe gjithçka duhej t'ekzistonte, nga Shkenca(ilm)paraekzistuese në **ATË(ALLAHUN)**, përmes fuqisë së **TIJ(Kudret)** dhe **Emrave të TIJ** më të bukur (**Esma-yl hysna**). Kështu ato që ne i quajm **ligjet e natyrës** ose **Rendi përgjithshëm** nuk janë gjë tjetër veçse **Rend (rregull), Sistem i ALL'LLAHUT**.*

30

*Qenjet njerëzore kanë gjithsesi nevoj të vetëdijësohen mbi njëmendësinë e **ALL'LLAHUT** në vet Qenësinë e tyre dhe t'i kthehen më mirë qenësisë së tyre se sa t'a adhurojnë një <<zot>>që u është i jashtëm (i huaj –themi kushtimisht).*

Ewliat, që të gjithë dhe tërë kohën kanë kërkuar t'i drejtojnë njerëzit drejt një studimi të Fesë së vendosur mbi bazën e konceptit <<ALL'LLAH>>dhe të cilët, më pastaj, pasi të kenë studjuar mirë përfundojnë në një gjendje shpirtërore <<të frikës>> (khashijat).

Nga ana tjetër, zyrtarët fetar gjithnjë kanë paraqitur <<një zot të largët>>dhe janë përpjekur t'i frikësojnë njerëzit, për të vendosur hegjemoninë e tyre si autoritete....

As **Kur'ani as Muhammedi alejhiselam** nuk kanë përshkruar një <<zot atje- jasht>>i cili n'a vështrohet nga jasht, n'a sygjeron për veprimet tona, pastaj pasi të ket menduar, n'a hedh në Ferin e tij ose n'a pranon në Parajsën e tij.

Përkundrazi, Libri ynë i Shenjt dhe i Dërguari **ALL'LLAHUT** n'a njoftojnë mbi njëmendësinë e **ALL'LLAHUT në vetveten tonë, në qenësinë tonë, që përbën vet njëmendësinë tonë!**

Ja përse fakti të përfolish dikend, të mashtrosh dikend, të veprosh padrejtësisht, realisht ishte në të vërtetë një fakt kundër<<**ALL'LLAHUT**>>, që është e Vërtetë(**hakikat**) në secilin prej nesh.

31 Ja që po për të njëjtën arsye, i Dërguari(**Resul**) i **ALL'LLAHUT** ka thënë:

<<Ju nuk do të jini falenderues ndaj ALL'LLAHUT aq sa jini falenderues ndaj robëve të tij (ndaj njerëzve)>>!

Po, është <<**ALL'LLAHU** >> që mbijeton mbi gjithçka, që ju e falenderoni, dhe jo një zot i përfytyruar në mendjen tuaj. Ne nuk mund t'a kuptojmë përsosurinë e <<**Fesë Islame** >>derisa ne nuk e kuptojmë si duhet këtë njëmendësi!

A mund pra ne t'a shenjojmë <<**ALL'LLAHUN**>> me emrin e <<**ZOTIT**>>?

Do të jetë kjo tema jonë vijuese.

* * *

7



A MUND T'A SHENJOJMË <<ALL'LLAHUN>> ME <<ZOT>>?

32

Një grup njerëzish, autorë teorish mbi <<Fenë>>duke u mbështetur në të dëgjua si dhe të dhëna të gabuara, përdorin pavetëdijshtëm fjalën <<Zot>>në vend të emrit<<ALL'LLAH>>, dhe mendojnë se këto fjalë kanë të njëjtin kuptim, duke ia bashkuar kështu patriotizmit tyre, sipas kapriceve të tyre...

Në kapitullin paraprak, ne jemi përpjekur të qartësojmë se fjala <<zot>> ka për premisë logjike një ide krejt tjetër nga emri <<ALL'LLAH>>. Janë dy fjalë të ndryshme, me domethënje krejtësisht të ndryshme, njera nga tjetra.

*Ne do t'a qartësojmë këte me një paragraf, nxjerr nga interpretimi **kur'anor** i interpretuesit të shkëlqyer **Hamdi Jazir Elmali** gjatë viteve të dyzeta, interpretimi më i hollësishëm i botuar në turqisht nga administrata për Çështje Fetare :*

<<Fjala ALL'LLAH nuk përdoret për asgjë tjetër vetëm për ALL'LLAH, qoftë në kuptimin e saj të mirëfilltë ose jo. Merrni shembull fjalët <<ilah>>dhe <<hyda>>, asnjera prej tyre nuk

është emër që i përshtatet <<ALL'LLAHUT>>. Ato kanë për premisë logjike një koncept të <<zotit>> ose <<zotëris>>etj... Ndryshe kurrë nuk kemi thënë <<ALLAHËT>>dhe nuk mund të themi kurrë. Nëse ne mund të dëgjojmë diç të tillë nga kushdoqoftë, ne mund të nxjerrim si përfundim se është i paditur, i pavetëdijshëm. Emri <<ZOT>> nuk paraqitet kështu ; ju mund t'i quani bile idhuj të rrejshëm <<zotash>>. Idhujtarët (mushrikët) kishin për zakon t'adhurojnë shumë zota. Disa syresh i kishin sa e sa zota, të tjerët i kishin aq e aq.

33

Pra emri i përgjithshëm ZOT nuk është një sinonim i emrit të përveçëm <<ALL'LLAH>>hiq më shumë se sa s'është i barazvlerëshëm me <<ALL'LLAHUN>>.<<Zoti>>është një emër shumë i përgjithshëm!Binaenalejh, Së këndeimi, nuk mund të përkthehet emri <<ALL'LLAH>>me <<ZOT>>(Vëllimi:1, f 24-25).

Ky shpjegim i shkëlqyer, sipërpermendur, i Kur'anit në turqisht, tregon qartë pse ne nuk do të duhej kurrë t'a quajmë <<ALL'LLAHUN>> <<zot>>.

Ne do të duhej poashtu t'i marrim parasysh këto vërejtje shumë shprehëse :

Emri <<zot>> është një emër i përgjithshëm, kurse <<ALL'LLAH>> është emër i përveçëm i një QENËSIE unike (Dhat), nga e cila varet tërë ekzistenca.

Dua të them se nuk është një çështje thjeshtë gjuhësore. Ekziston një dallim i madh në domethënien e këtyre dy fjalëve.

Të kuptuarit e një feje me <<adhurimin >> e një <<zoti>> është i rrem dhe i pabazë!

<<Feja Islame>>burimore është mbështetur krejtësisht mbi ate që ka për premisë logjike emri <<ALL'LLAH>>.

Dëshmia <<La ilahe illa-ALLAH>>do të thotë <<nuk ka zot, ka vetëm <<ALL'LLAH>>. Për të qenë musliman i mirë, së pari duhet kuptuar këte mirë.

Nëse kufizohemi në konceptin e <<zotit>>, ne e bëjmë në dëm të asaj që ka për premisë logjike emri <<ALL'LLAH>>dhe ne nuk do të mund t'a kuptojmë misterin e kalifatit.

*<<Zoti>> është një qenje që adhurohet atje, **largë jush!***

<<ALL'LLAHU>> është Njëmendësia (Hakikat)në Qenësinë tuaj!

34

<<Zoti >> është një dordolec për t'i frikësuar njerëzit!

*<<ALL'LLAHU>> është për njerëzit që përsiasin, burim i një nderimi, (përgjërimi-dashurie) të thellë, të një frike (**khashijat**) të prodhuar nga të kuptuarit e kotësisë(hiçit) tyre përball vazhdimsisë, të pafundësisë së<<ALL'LLAHUT>>.*

<<Zoti>>është ky që mendohet(sypozohet), qeveris dhe gjykon nga largë dhe që është skalitur në mendjet e njerëzve të paditur sipas tekave të tyre.

*Ndryshe<<ALL'LLAHU>> është **NJË** dhe **QENJE** e **VETME** e Përkryer, që ka krijuar gjithësitë Vetvetiu dhe I CILI manifestohet përmes Emrave të TIJ (Esma) në çdo grimcë, dhe **ATIJ** askush nuk i është i barabartë(nuk krahasohet me askë dhe me asgjë)!*

<<Zoti >> është një qenje e përfytyruar, e skalitur në mendjet e njerëzve, të cilit ia veshin aftësitë që ndryshojnë sipas përkapjes së çdo bashkësie dhe sipas shkallës të të kuptuarit të secilit.

<<**ALL'LLAHU**>> është **EHAD** (NJË i Përkryer), Samed, Lemjelid dhe Lemjuled.*

Meqë është kështu, kush është autorizuar pra të qeveris n'emër **t'ALL'LLAHUT** dhe n'emër të Fesë.

* * *

*Për më shumë hollësi, shihni librin tonë të titulluar:<<**ALL'LLAHU i lajmëruar nga Muhammedi**>>.

8



KUSH ËSHTË I AUTORIZUAR N'EMËR T'ALL'LLAHUT OSE TË RELIGJIONIT?

36

*Aktualisht, një nga çështjet që kanë të bëjnë me << **Fenë Islame**>> ku secili gjykon veprimet e tjetrit **N'EMËR T'ALL'LLAHUT** dhe nxjer përfundime. Secili qorton dhe kundërshton zëshëm gabimet e tjetrit nëse veprimet e tij dallojnë nga të tjetrit dhe përfundimisht konkludon se **ALL'LLAHU nuk do t'i pranoj veprimet e tjetrit >>.***

Sa më i paditur të jetë një individ, aq më shumë gjykimet e tij janë të kësaj natyre.

Para së gjithash, ne duhet të dijmë që, asnjëri mbi tokë nuk është i thirur (mbase nuk ka vlera) të flas ose të gjykojë n'emër t'ALL'LLAHUT bile qoftë ai edhe pejgamber (!) Një individ që thotë se është i zoti të bëjë këtë, është padyshim i marrë, e ai që i beson është zhytur në injorancën më të thellë, s'ka më keq.

Në jetë, ne të gjithë mund të flasim dhe t'i shprehim interpretimet tona sa i përket << Fesë Islame>> duke u mbështetur në mësimet e Pejgamberit Muhammed

alejhiselam dhe mbi Kur'ani Kerimin. Megjithate, pa marr parasysh kush jemi ne, asnjë nga shpjegimet tona vetanake dhe idetë nuk mund të bëhen NË EMËR T'ALL'LLAHUT ose të Fesë.

Ishte, vetëm Pejgamberi i fundit Muhammedi alejhiselam, që kishte vlera për të folur N'EMËR T'ALL'LLAHUT dhe të Fesë mbi tokë. Ai ka kryer Detyrën e tij Fisnike (të Lartë)dhe është ndarë nga kjo botë për Tjetrën (ahiret)që katërmbëdhjetë shekuj.

Dhe vetëm pas kësaj figure të shquar njerëzit kanë shprehur gojarisht ose me shkrim, mendimet e tyre dhe konkludimet mbi Fenë, duke ndjekur Dritën e marr prej tij, dhe ate sipas SHKALLËS TË TË KUPTUARIT TYRE.

37

Secili prej nesh mund të përfitoj nga epërsitë e njohjes së tjetrit, nga mendjeprehtësia e tij, dhe nga niveli i shkencës së tij duke qenë se KRIJUESI ynë, <<ALL'LLAHU>> e ka pajisur secilin prej nesh me një talent dhe me një përsosuri që janë veçori të tij. Megjithate, Resul-ALL'LLAH Muhammed Mustafa alejhiselam është gjithnjë njeri i vetëm, të cilit t'u nënshtrohet mbar bota!

Ne jemi të lirë t'ua bëjmë të njohura mendimet tona tjerëve....Ne mund t'u përgjigjemi pyetjeve të tjerëve, duke përdor shprehjet : <<sipas mendimit tim >>, ose <<me aq sa di unë >>...Kështu përgjigjet që do t'i japim reflektojnë opinionet tona vetanake të vendosura mbi bazën e bindjeve tona MBI FENË. E meqë mendimet e tilla nuk janë bërë N'EMËR T'ALL'LLAHUT ose të Fesë, prandaj ato edhe nuk obligojnë asnjëri që t'i ndjekin.

Pra nuk është në kompetencat e individit t'i kritikojë të tjerët lidhur me respektimin ose jo të rregullave të fesë e aq më pak të gjykojë se do të shkojë ose jo në Fer ose Parajs, për shkak të

veprimeve të tyre. Vetëm <<ALL'LLAHU>>ka pushtet absolut t'i gjykojë veprimet e secilit....

Ju mund të zgjidhni dikend, njohja e të cilit ju frymëzon me besim dhe bëhet udhëheqësi juaj shpirtëror gjatë jetës suaj...Mirëpo, ju poashtu duhet t'a kini parasysh seriozisht faktin se mësimet e këtij udhëheqësi(drejtuësi-frymor) janë SUBJEKTIVE, dhe nuk reflektojnë të Vërteten e përsosur dhe absolute t'ALL'LLAHUT ose të Fesë!

Ja përse ne nuk duhet në asnjë rast të kritikojmë, t'i dënojmë njerëzit mbi bazën e njohjes së fituar përmes këtij që ne e kemi zgjedhur si, mësuesin (hoxhën), sheikun tonë, udhëheqës ose arsimtar. Ne duhet t'a jetësojmë që gjykimi fundit (hukm) i mbar botës i përket ALL'LLAHUT!

38

Ne para së gjithash nuk kemi ardhur në këtë botë me qëllim që të vendosim një pushtet, të mbretërojmë në sulltan ose t'i udhëheqim njerëzit thjeshtë për kënaqësitë tona!

A e dini ju se unë jam PËR <<HILAFET>>?

Këte temë do t'a shqyrtojmë në kapitullin vijues!

* * *



UNË JAM PËR HILAFET(KALIFAT)

40

Kur'ani -Kerim pohon se<< ALL'LLAHU e ka krijuar njeriun që të jetë halif i TIJ në tokë>>.

Së këndejmi rrjedhë se çdo qenje duhet të jetësojë në vetveten e tij përsosjen që lypset nga statusi i<<halifit t'ALL'LLAHUT>>. Kjo do të thotë se secili do të bartë përgjegjësinë e vet<< hilafetit tij>>(të qenit tij halif).

Ata që e mbështesin bindjen se<<Feja Islame>> e konsideron gruan si një qenje të shkallës inferiore, janë prej atyre, që nuk kanë kurfar ideje mbi vlerat kur'anore....

Kur Libri i Shenjt shënon qartë se<< njerëzimi qe krijuar për të qenë halif në tokë >> pa dallim burr, grua, si mund të mendohet atëherë se gruaja na qenka qenje e kategorisë e dytë?

Që të gjithë, burra e gra janë krijuar për të qenë njësoj halifë t'ALL'LLAHUT në tokë!...

Ja përse qenjet njerëzore duhet t'a kuptojnë domethënjen e këtij <<hilafeti>> sa më parë që është e mundur, në mënyrë

që t'i përmbushin kërkesat e tij. Ndryshe, do të jetë shumë vonë për t'a zënë kohën e humbur, gjatë hilafetit tyre. Sepse kur të ndërgjegjsohet njeriu për shpërfilljen e mosjetesës në hilafet, pason vuajtja e dënimit të përherëshëm dhe nuk do të ket më rast tjetër për t'u(penduar) në jetën e pas vdekjes!

Unë jam për <<**halifat**>>dhe çdo"**halifi t'ALLAHUT**" i dëshiroj të vetëdijësohet mbi rëndësinë e këtij misioni në tokë, në mënyrë që të jetojë duke vepruar si i tillë (në jetën e kësobotshme)!

Qëllimi i të gjitha punimeve të mija është që t'i udhëzojë njerëzit në këtë rrugë...

41 **Një" kalifat(hilafet)" i tillë kërkon nga qenjet njerëzore jetësimin e tërsishëm të vlerave që paraqesin Emrat më të Bukur t'ALL'LLAHUT. Sipas sufive(taşawwuf) nga i tërë krijimi, qenjet njerëzore përbëjnë gjininë(llojin) më të nderuar, si(shprehje) manifestim i Emrave t'ALL'LLAHUT...>>**

Mendoni mirë! Kur ALL'LLAHU thotë, nga gjithë ajo që krijova, krijova njeriun si qenjen më të nderuar! Ai nuk bën dallimin ndërmjet burrave e grave. Që të dyja palët janë nderuar njësoj! Ata që nuk mund t'a kuptojnë këtë qartë, le të ulen dhe le t'a qajnë vetveten(mosdijen e vet)!...

Po....Sa i përket natyrës njerëzore, burrat dhe gratë, që të gjithë, pa dallim janë më të nderuarit nga tërë krijimi, njësoj sikur që edhe u është besuar statusi <<**halif i ALL'LLAHUT**>>(zëvendës)në tokë, pikrisht sepse të gjithë kanë ardhë në botë, duke bartur në vete, cilësitë e << **Emrave më të Bukur t'ALL'LLAHUT**>>.

Është fare e rëndomtë për ate(individin) që e konsideron veten si një trup nga mishi e gjaku, t'a mohoj nderimin(që i është bërë) dhe <<**halifatin**>> e që e ka zanafillën(burimin) në vet

Vërtetsinë e tij “Hakikat”, duke menduar se nuk ka më jetë pas vdekjes. Përfundimisht, ka për t’a humbur nga thesarët e paçmueshëm...

Bartja e tipareve të <<**Emrave më të bukur t’ALL’LLAHUT**>> në qenjen tonë ka për premisë logjike këte : Qenjet njerëzore vazhdojnë të jetojnë përjetësisht dhe pa ndërprerje, duke kaluar nëpër nivele dhe përmasa të ndryshme.

Sa më shumë që individ i njeh dhe i zbulon këto cilësi, me të cilat e ka pajisur ALL’LLAHU, dhe i cili i sendërton gjatë zhvillimit të jetës së tij në këtë botë, duke qenë <<halif>>, aq më shumë ai do të jetë në gjendje të lirohet nga vështirësitë dhe gabimet në mbretërinë e jetës së ardhme, gjithnjë duke gëzuar lehtësitë, përpjestimisht me shkallën e njohjes(së vet) që do t’a deponojë.

42

Nga ana tjetër, sa më pak që individ i njeh njëmendësinë e vet, aq më shumë jeta e tij shndërrohet në Fer. Kjo vuajtje ka gjasë të jetë e pambarim...

Mënyra më e mirë t’a qojë kah e mira <<**hilafetin**>> e tij, qoftë burri ose gruaja, është para së gjithash ; t’a njohë, t’a kupojë dhe t’a jetësojë vet **Njëmendësinë e tij (saj)(Hakikat)**. **Dituria(shkenca e ALLAHUT-ilmi)** dhe **DHIKRI** hapin rrugën në jetësimin e kësaj. **DHIKRI** ndihmon trunin e individit të zhvillojë aftësinë e tij dhe t’arrijë nivelet më të larta të ndërgjegjes, të urtësisë, kështu i ndihmon individit të jetësojë vet <<**Vërtetësinë**>>e tij dhe të njejtësohet me **MORALITETIN E ALL’LLAHUT**.

Pejgamberi ‘Isa alejhiselam thotë <<me mendue sipas ALL’LLAHUT>>.

Në këtë kontekst edhe Resul-ALL’LLAHU thotë <<Njejtësohuni me atributet(tiparet e ALLAHUT). *

Kjo na shtyn t'i respektojmë fshehtësitë e krijimit sipas mënyrës së ALL'LLAHUT, në dliresi të plotë pasi që ne të jemi liruar nga të gjitha kushtëzimet, dhe nga tërë bindja e paraformuar dhe i tërë gjykimi i fituar në rrethin tonë shoqëror.

N'a mundësohet t'a jetësojmë këte, vetëm nëse ne rrisim aftësinë e trunit tonë dhe ne e vlerësojmë atë në dritën e shkencës së vërtetë....

Vetëm pasi të lirohemi nga paragjykimet, duke qenë ky edhe synimi ynë, ne mund t'a çmojmë shkencën si duhet, në kuptimin e saj të mirëfilltë.....

43 *Hapja ndaj ideve të reja! Lirimi nga <<fshikëza e së kaluarës >> si dhe të jesh i (e) aftë për të vështuar jasht!*

Do të jetë kjo tema e kapitullit vijues : DALJA NGA FSHIKËZA E SË KALUARËS!

* * *

**(Sqarim-kjo më saktësisht nënkupton: t'i përbrendësojmë cilësitë e ALLAHUT si atribute të Emrave të TIJ më të bukur) në vet qenjen tonë-me çka na ka pajisur ALLAHU dhe t'a jetësojmë misionin tonë në tokë përmes këtyre cilësive duke vepruar).përkth.*

10



TË LIROHEMI NGA FSHIKËZA (GUASKA) E SË <<DJESHMES>> DHE T'A ARRIJMË QENËSINË

44

I dua shumë këto vargje të poetit sufi Mewlana XHELALUDIN, që janë shumë shprehëse :

<<Të gjitha fjalët e shqiptuara dje,

kanë ikur me <<dje>>, i dashuri im!

Sot është koha të themi gjëra të reja...>>

Kjo thënjë ka për qëllim <<islamizmin >>por jo <<Fenë Islame>>. Siç kam thënë tashmë, <<Feja Islame >> është një SISTEM, një Rend i përgjithshëm i jashtëkohëshëm, i vendosur nga ALLAHU. Të gjithë Pejgamberët ua kanë shpjeguar popujve të vet këtë SISTEM, këtë REND të përgjithshëm, sipas shkallës të të kuptuarit të tyre. Së këndejmi, mendohet se fetë e ndryshme tek popujt e ndryshëm kanë lindur n'emër të Pejgamberve të vet.

Ky Sistem, ky Rend i përgjithshëm, i jashtëkohshëm, i njohur poashtu si <<Sunnet-ALL'LLAH>>, nuk ndërron fare e as që përtritët.

Mbetet i njejt, i tillë siç ishte para krijimit dhe do të mbetet i njejt pas Gjykimit të Fundit (kijametit)...Ne e shenjojmë poashtu edhe si<<ligjet e natyrës>> sipas të kuptuarit tonë.

*Mund të rishikohet (ose rishqyrtohet)mënyra e të kuptuarit të<<Islamizmit>>si dhe të bëhet rivlerësimi i <<Fesë>>, por jo vet- **SISTEMI**.*

*Pak nga pak me kalimin e kohës dhe me zgjimin e ndërgjegjes së njërëzve, me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë, mund të bëhet edhe rivlerësimi i <<**Fesë Islame**>>. Kjo për arsye se , shumë gjëra që janë hedhur poshtë deri dje (pra në të kaluarën), si të papranueshme, në mungesë të një të kuptuari të thellë, tash janë bërë, obligime(detyra) të domosdoshme, me rëndësi, të propozuara me **SISTEMIN** dhe **Rendin(e ALLAHUT)**.*

*Kështu ndryshimet e sipërmendura(përtritja e “Fesë Islame”) bëhet(n) ashtu që njerëzit t’a kuptojnë << **Fenë Islame**>>, që do të thotë brenda<<Islamizmit >> tyre, e jo përtritje(ose ndryshim) brenda përbrenda vet <<**FESË**>>....*

*Poashtu edhe vargjet e sipërpërmendura, të **Mevlana Xhelaludin(Rumi)** kanë të bëjnë me përtëritjen e shpjegimit dhe fthillimit të <<**Fesë**>>, pra rishikimi i tyre, në dritën e të dhënave të reja, që të vlerësojnë rëndësinë e njëmendtë të shumë gjërave që nuk njiheshin në të kaluarën.*

*Sepse nëse ne nuk do të veprojshim kështu, do të mbeteshim të burgosur brenda **fshikëzave(guaskave)** tona, kështuqë të kuptuarit tonë do të kufizohej në njohjet e fituara që prej kohësh në kushte tjera, pa asnjë përmirsim. Me gjithë*

përparimin e gjithëmbarshtëm në çdo fushë të jetës, ne do të zhytemi në padituri dhe nuk do të jemi në gjendje t'a kuptojmë dhe t'a vlerësojmë Fenë. Është e pamundur t'a arrijmë thelbin e çështjes nëse nuk lirohemi nga fshikëza e së<< djeshmes >>....

*Ndryshe i Dërguari i **ALL'LLAHUT** ngulmon mbi **domosdon e përparimit** në këtë kuptim që ndihmon për të kuptuar më mirë Fenë... Ai ka thënë kështu :*

<<ALL'LLAHU dërgon një <<Myxheddid >>(ky që është i ngarkuar me përtërijtjen) në fillim të çdo shekulli që t'a përtërij të kuptuarit e Fesë!>>.

Këto fjalë të Pejgamberit shënojnë qartë domosdonë e një rirespektimi të rregullt të <<Fesë>> për t'i kënaqur kushtet e tashme.

46

Megjithatë ne duhet të kuptojmë se nuk do të ketë REFORMË në FE, sepse është <<ALL'LLAHU >>që e ka FORMUAR Fenë. Ndryshe, ne mund t'a mendojmë një reformë në mënyrën e të <<kuptuarit >>të Fesë dhe <<vlerësimin>> e saj.

*Ne nuk jemi në gjendje të zbulojmë ardhjen e mundshme të një <<Myxhedidi>> të ri në fillim të shekullit të shekullit 14-të Hixhre, duke u nisur nga Indonezia deri në Marok, Tunizia, Algjeria, sikur që ne nuk mund të zbulojmë nëse ky **Myxheddid** tashmë ka ardhë, do të vij së shpejti ose nëse ka pasur nga një **Myxheddid** në gjirin e çdo bashkësie (xhemmati)!Kjo është një çështje që i përket njerëzve të cilëve u është dhënë dhuntia.*

Duke qenë se i kam kaluar tashmë të pesëdhjetat, fundi im ka gjasë të jetë më afër!

Kështu, sa me përket mua, shqetësimi im kryesor është t'i drejtohem shpjegimeve të **Resul-ALL'LLAHUT** që më njoftojnë se do të jem i vendosur në një var krejt vetëm, dhe aty, do t'i përgjigjem engjuve(melekve)krejt i vetëm....

Në varrin tim, do të pyetem lidhur me Rabb-in (Zotin) tim, Nebi(Pejgamberin)dhe Librin tim, mirëpo, nuk do të pyetem mbi shkollën time juridike të preferuar (medhhebin), drejtimin e veçant që zgjodha(tarikat), sheikun tim, udhëheqësin ose Hoxhën apo edhe të gjitha lidhjet tjera....

Pra, unë mendoj, dhe ky është mendimi im vetjak, që para së gjithash dua të kuptojë seriozisht konceptin e <<**ALL'LLAHUT**>>, i tillë siç është shpjeguar në Kur'an, në mënyrë që të pohojë se <<**Zoti im është ALL'LLAHU.....**>>

Unë dua të kuptojë se çfar do të thotë << **Resul-ALL'LLAH**>>, çfar lloj detyre Pejgamberi Muhammed ka kryer...se çka donte të më kumtonte, që të mund të pohojë se<<**I Dërguari im-Nebi është Resul-ALL'LLAH Muhammed Mustafa** dhe unë poashtu dua të jem i aftë të Lexojë (ikree) <<**Kitab-ALL'LLAH**>>(Librin e **ALL'LLAHUT**)që të pohojë se Libri im është <<**Kitab-ALL'LLAH**>>ose të tregojë se Kur'ani Kerim është një libër i shpallur nga <<**ALL'LLAHU**>> dhe i vërtetuar, që të mund të pohojë se <<**Libri im është Kur'ani-Kerim!**>>.

Pa dyshim, një njeri i arsyeshëm nuk do të rezikonte të bënte gabime të panumërta, të shpërfillte një punë aq të rëndësishme për jetën e tij të përjetshme të pas vdekjes, dhe të jipet pas gjërave për të cilat nuk do të shpërblehet kurrë pasi t'a lë këtë botë fizike.

Së paku është e paarsyeshme të lidhen bestytnitë dhe përrallat tjera absurde me <<**Fenë Islame**>>dhe pastaj të përdoret ky devijim si argument për t'a mënjanuar parimin

Islam. Mirëpo tridhjetë e tre vjetë hulumtimi të thellë si dhe ibadeti(praktikat) më kanë dhënë prova që çdo parim, të cilin i Dërguari i ALL'LLAHUT n'a e ka nënshtuar, përmban një logjikë, një urtësi dhe një shpjegim shkencor.

Sidoqoftë, ne nuk duhet të kufizohemi, e as t'a kufizojmë <<Fenë Islame>> n'interpretime të bëra nga të tjerët në periudha dhe rrethana krejtësisht tjera.

* * *

11



KUPTONIE <<ISLAMIN>> E JO <<ISLAMIZMIN>>

50

Në këtë botë ka mendje të ndritura dhe të pseudondritura.....

Ka intelektual dhe pseudointelektual...

Ka edhe bari dhe dele që presin të drejtohen urtësisht.

Dhe nëse ka <<ISLAM>>po kështu ka edhe<< islamizëm>> të njerëzve.!

Mendjendriturit janë ata që bëjnë hulumtime e gjejnë dhe e njohin të Vërtetën, mbi baza të hulumtimeve të tyre vetjake, objektive nga burime të sigurta. Ndryshe, menjendriturit e rrejshëm janë ata që përfitojnë nga njohja e të parëve sipas shkallës të të kuptuarit tyre dhe pastaj përpiqen të nxjerrin përfitime duke ua shitur të tjerëve.

Ka intelektual në këtë botë...

Këta janë ata, të cilët në njëfar mase kanë dalë nga fshikëzat e tyre dhe përpiqen t'a qojnë një jetë të udhëhequr nga logjika e mendimit shkencor.

Pseudointelektualët lakmojnë pozitativ dhe mënyrën e jetës të këtyre të parve. Ata i imitojnë, dhe bëjnë çmos që t'u ngjajnë, në veshje, në haje, në pije, në të folur dhe të jenë të drejtuar si ata, në gjirin e shoqërisë së intelektualve!

Mendjendriturit e rrejshëm dhe intelektualët e rrejshëm janë si diamantet e rrejshëm që vezullojnë në sytë e naivëve.

Shkëlqimi tyre tërheq njerëzit për anash. Mirëpo ende nuk janë rehur si duhet, ndaj edhe nuk janë të zotë t'a bëjnë dallimin ndërmjet diamantit të vërtetë dhe atij të rrejshëm. Ndryshe, qëllimi tyre është vetëm diamanti rrejshëm. Janë të gatshëm të flijojnë gadi krejt çka kanë, vetëm t'u ngjajnë të sipërpërmendurve.

51

*Ka prej tyre që e kanë të lindur këtë lakmi për t'udhëhequr. Bëjnë çmos që të qeverisin dhe u imponohen njerëzve, thjesht vetëm për kënaqësinë e tyre fizike dhe morale. Formojnë grupe për t'i udhëhequr, japin urdhëra, sjellin kufizime dhe ndalesa që t'i kënaqin **dëshirat e tyre ushtarake të pajetësuar në ndërdijen e tyre**. Pastaj ka të tillë që me afsh dëshirojnë të jenë të udhëhequr, duke gjetur aty njëfar sigurie dhe një mbrojtje, gjithnjë me shpresë që t'i fshehin dobësitë e tyre dhe të gjejnë paqjen.*

Ja që kështu ndodhin gjërat, kudo që të ndodheni, në Turqi ose gjetu nepër botë!

*Megjithatë **ALL'LLAHU** e krijoi njeriun dhe e lartësoi atë në shkallën më të lartë, duke e dalluar nga krijesat tjera << si **qenjen më të nderuar**>>nga tërë krijimiTIJ, dhe e bëri **halif** (zëvendës) të TIJ në tokë....! Mirëpo kush e **mendon këtë?***

Pseudointelektualët si dhe mendjendriturit e rrejshëm, e komentojnë njësoj, në të njëjtën mënyrë, <<Islamizmin>> njerëz të dirigjuar, të mbështetur mbi thash e thënat anash

dhe mbajnë fjalime në kundërthënje të plotë me logjikën, mendjen, arsyeshmërinë dhe shkencën. Ata mendojnë se e sulmojnë <<Fenë Islame>> duke e kritikuar fenë e <<Islamizmit>>(ose fenë muslimane)të njerëzve, gjithnjë duke sjellë si dëshmi shkallën e ultë të zhvillimit të Muslimanëve, krahasuar me kombet tjera.

Duke qenë se nuk janë të vetëdijsëm se janë vetëm pseudointelektual ose mendjendriturë të rrejshëm, ata nuk dijnë se <<Dini ISLAM>>dhe <<Islamizmi>>janë dy koncepte krejtësisht të ndryshme dhe dallojnë në thelb njera nga tjetra. Sikur edhe nuk dijnë, se asnjëri nuk duhet të prekë në çështjet fetare, së paku të vetëdijsohen mbi një dallim të tillë.

52

Në fakt, ata kanë lënë m'anash vlerën e diamantit të vërtetë, të pavetëdijshëm se janë kthyer kah imitimi tij, me mendimet dhe pikëpamjet e atyre që kanë për pasion dirigjimin dhe nënshtrimin, gjithnjë duke menduar se përfaqësojnë sistemin e mendimit të bazës së <<Dinit ISLAM>>.

Atëherë çfar mund të presim prej injorantësh të tillë, të pambrojtur, që të vetmin referim e kanë melodinë e popullarizuar të atyre që kanë për pasion dirigjimin dhe dëgjueshmërinë(nënshtrimin).....

*Duke menduar se kjo është <<Feja Islame>>, ata e gjykojnë në funksion të asaj që kanë mësuar përmes<Islamizmit>>ku leximi melodik i poemës duke i bërë lavdat –urim Muhamedit(Mewlydi) si dhe kremtimi i netëve nën dritën e qirinjëve, janë konsideruar si **praktika fetare (ibadete)**, ose edhe **bartja e një shamie në kokë**, sikur t'ishte kjo ndër kërkesat e para të **Islamit** për femnat, dhe ku namazi(salati) dhe agjërimi janë menduar se janë urdhëra që vijnë nga një*

zot hyjnor që **qëndron mbi botën**, dhe njerëzit duhet t'i praktikojnë për të kënaqur dëshirën e këtij zoti...

Ata nuk kuptojnë se poemat e tyre të shenjta qenë shkruar nga njerëz të thjeshtë, (sikur "**Mewlydi "i Sylejman Çelebiut**") dhe se nuk kanë të bëjnë fare me praktikat që ua këshillon **Kur'ani -Kerim** qenjeve njerëzore.... Ata nuk e dijnë se qirinjtë e ndezur mbi var nuk kanë kurfar lidhje me <<**Dinin- Islam**>>, dhe se vetëm nata e **Miraxhit, Beratit, Kadrit**, fshehin në vete orët e çmuara. Ata nuk dijnë se nuk ka festa fetare të festuara me ëmbëlsira ose flijime dhe se janë vetëm **Ramazan Bajrami**(festa e mbarimit të muajit të agjërimit) dhe **Haxhi (Haxhillëku në Mekke)** janë festa që shënohen. Ata nuk kanë kuptuar se praktikat e përmendura në Kur'ani Kerim, siç janë : **Namazi, agjërimi dhe Haxhi** (shkuarja në Mekke) nuk janë dedikuar që t'i pëlqejnë një zoti, që qëndron (diku lartë)mbi ne, por janë këshilluar për shpëtimin e secilit në jetën e pas vdekjes....

<<**Dini ISLAM**>> është një Sistem, një urdhër i përgjithshëm jashtëkohor, i vendosur nga ALL'LLAHU. Zanafillën e tij nuk e ka prishur(shtrembëruar)koha. Pohon Kur'ani!

Përkundrazi, <<**Islamizmi**>>është një interpretim i <<**Din al Islam**>> nga njerëzit, sipas aftësisë së tyre, kushtëzimit tyre krahas traditës dhe zakoneve të mjedisit tyre të sjellura nga <<çobanët >> tyre.

Tash që ju të kuptoni se <<**Din al ISLAM** >>nuk kufizohet në kurfar interpretimi, përpiquni të depërtoni në Fillet e tij! Shkarkohuni nga <<**Islamizmi**>>, dhe respektoni <<**Din-in Islam**>>.

Në kapitullin e ardhshëm t'i vejmë në pah dallimet.

12



DALLIMI NDËRMJET <<ISLAMIZMIT>> DHE <<DIN AL-ISLAM>>

54

Ne nuk jemi vetëdijshur mbi dallimin e madh që ekziston ndërmjet <<Islamizmit>> dhe <<DIN-it - ISLAM-(Fesë Islame)>>, ose thjeshtë nga mosdija, sepse ne i pranojmë verbëtas disa të dhëna pa asnjë hulumtim paraprak nga ana jonë. Sidoqoftë ky është një gabim, sepse në fakt fjala është për dy koncepte krejtësisht të ndryshme.

Qëllimi ynë në rradhë të parë është <<ALL'LLAHU>> lidhur me dy fakte shumë domethënëse :

- 1. Nga njera anë, dallimi ndërmjet konceptit <<Zot>> dhe Emrit <<ALL'LLAH>>.*
- 2. Nga ana tjetër, dallimi ndërmjet dy koncepteve <<Islamizmi>> dhe <<Din –i -ISLAM>>.*

Ne tashmë e kemi shpjeguar të parën në kapitujt paraprak. Kush prej jush dëshiron të dij më shumë mund t'i referohet veprës së titulluar: <<ALL'LLAHU I LAJMËRUAR NGA MUHAMMEDI>>, që është botuar 11 herë në turqisht dhe

shtatë herë n'anglisht; ekziston poashtu edhe ne frengjisht. Librat tonë janë falas dhe mund të tërhiqen në Shtëpinë botuese **KITSAN, në numrin e faxit :++90.212.5115144.**

Tash po i kthehem temës sonë lidhur me dallimin ndërmjet

<<Islamizmit>>dhe <<Din -i-ISLAM>>.

Din -i- ISLAM(-Feja ISLAME) është një **SISTEM, një REND(RREGULL)** i përgjithshëm jashtëkohor, i vendosur nga **ALL'LLAHU** për njerëzimin. **ALL'LLAHU** e shpjegon përmes fjalëve të të **Dërguarit TIJ, (Resul)**. Qëllimi tij është të ndërgjegjësohen njerëzit mbi faktet e rëndomta dhe të përjetshme, tej preokupimeve dhe dëshirave të tyre të përditshme, në mënyrë që të jetësojnë që **<<ALL'LLAHU>>**është Njëmendësia e tyre dhe që vet ata t'ia ndërtojnë vetedit jetën e tyre të përjetshme, duke i vënë në zbatim cilësitë e **ALL'LLAHUT** që i mbajnë në vetveten e tyre.

Një **<<Muslim>>**, ndjek mësimet e Pejgamberit sipas shkallës të të kuptuarit tij.**<<Islamizmi>>** është ajo çka njerëzit kanë kuptuar dhe e kanë pranuar, marr në përgjithsi, shpjegimet e Resul-**ALL'LLAHUT** dhe ffillimin e tyre sipas aftësisë së tyre vetjake. Të gjithë muslimanët janë implikuar.

Secili prej nesh mund të jap shpjegimin e vet sa i përket **<<DIN-it-Fesë>>**mbi bazën e të kuptuarit tij, të njohjes, të përvojës, të mjedisit tij shoqëror, të aftësisë së tij, të shkallës së ndikimit të njerëzve që e rrethojnë mbi arsimin e tij dhe mbi gjykimet e tij.Të gjithë këta janë faktorët që ndihmojnë të formojnë të ashtuquajturin **<<Islamizëm>>.**

<<DINI ISLAM>>, nuk është diç relative ; nuk mvaret nga përceptimet personale. Ai është i përsosur, i vendosur dhe i

*pandryshueshëm. Ky **SISTEM, KY REND(RREGULL)** poashtu është shenjuar me emrin <<Synnetullah>>në Kur'ANI-Kerim.*

Pa marr parasysh kush jini ju, as gjendja (niveli) në të cilë(i)n ndodheni ju, nuk ka rëndësi, secili bën më së miri atë që di, për t'a kuptuar sa më mirë këtë SISTEM.

*Çdo gjë që nga krijimi dhe ekzistenca e masave galaktike deri tek kodet gjenetike, është përfshirë në këtë <<**SISTEM**>> dhe çdo gjë i nënshtrohet një rregulloreje.*

Sigurisht që njeriu nuk është një hallkë e këputur nga zingjiri, që shtrihet që nga gjenet e deri në yllësi. Kjo duket plotësisht e arsyeshme, meqë ai është ndarë nga mendësia materialiste dhe i kupton gjërat shkencërisht, i din ato.

56

Fatkeqësisht, një numër i madh i muslimanëve janë lindur dhe ritur<<n'Isislamizëm>>, të mbërthyer në fshikëzat e tyre, pa e njohur <<Dinin ISLAM>>.

Dhe ja pyetja, e cila shtrohet vazhdimisht: Meqë Kur'ani është një Libër aq i madh, si ndodhë që bota muslimane të jetë aq e prapambetur dhe shtetet islame të llogariten ndër vendet e pazhvilluara ?

Më lejoni, që në vazhdim, tash t'ua shtroj pyetjen me sa vijon: A thua edhe sa kohë ne do të vazhdojmë me këtë fe <<t'Isislamizmit>> që ka zëvendësuar <<Dinin(Fenë ISLAM(E))>>pasi që e ka kufizuar në një fe të thjeshtë formalitetesh dhe në adhurim të një zoti atje diku lartë në qiell, me shpresë që të fitojë diçka?

*Ku mund të na qoj kjo rrugë kur **“Dinit-Islam”(Fesë Islame)**, t'i shoqërojmë aq epope, bestyttni, përralla absurde dhe gjëra të palogjikshme, duke pritur shpresë nga qielli, në vend se të*

merremi me studimin e **Librit** të **ALL'LLAHUT** dhe t'a kuptojmë ate sa më mirë?

Duke i lexuar dhe përsëritur librat e një drejtuesi-udhëheqësi(shpirtëror), ndoshta edhe pa i kuptuar fare, nuk do të mund të dalim kurrë nga fshikëza e fesë së <<Islamizmit>> dhe nuk do t'a arrijmë kurrë <<Dinin(Fenë)Islame!

Ju kini nevojë të veproni individualisht me vet të kuptuarit tuaj, duke këmbyer ide me të tjerët. Sepse ju do të kaloni në mbretërinë e të pas jetës (n'ahiret) krejtësisht vetëm dhe ju do të jipni llogari poashtu vetëm.

- 57 Ata që i autorizojnë njerëzit që ti lexojnë vetëm mësimet e librave të tyre dhe ndalojnë tjerat janë varrmihësit e <<Dinit(Fesë)Islam(e)>>, ndonëse hiqen të jenë Mësuesit e <<Fesë së Islamizmit>>.

Ju kini nevojë t'arrini të kuptoni vet sipas aftësisë të të kuptuarit tuaj, me përpjekje të mëdha duke i lexuar veprat e mësuesve të mëdhenj(mjeshtër të pendes dhe të mendjes) frymëzuesit shpirtëror, dijetarët e shquar si : **Imam GAZALIU, Shahi NAKSHIBANDI, Abdylkadër XHEJLANI, Haxhi Bektash Wali, Mewlana dhe Said NURSI**. Ju duhet t'i lexoni njerin pas tjetrit, që të shihni se si e kanë kuptuar secili prej tyre <<Dinin Islam>>; gjë që do të ju ndihmonte të pushoni me të imituar dhe të mos vareni më nga një bari(çoban), dhe kështu të njihni <<Dinin ISLAM>>e t'arrini të <<Vërteten >>(hakikat)!

Qoftë fjala për muslimët ose jomuslimët, nuk ka mënyra tjera për t'u liruar përveç rishikimit dhe rivlerësimit të <<Dinit ISLAM>> në një gjendje shpirtërore të pastruar plotësisht nga pikpamja materialiste.



ISLAMIZMI MATERIALIST

58

Disa muslimanë do t'a kuptonin më mirë <<Dinin ISLAM >>, nëse do t'a çlironin vetveten nga ndikimi i të menduarit materialist (fizik epshor). Ata do t'a kuptojshin madhshtinë e dimensionalitetit brenda shpjegimeve të<< Dinit Islam (Fesë ISLAME)>>dhe do të kuptonin çfar është ky SISTEM për të cilin ky DIN ka treguar.

Ç'kuptojmë me lirim e muslimanëve nga ndikimi i perspektives materialiste?

<<Feja ISLAME>> ka pësuar deri më sot dy mënyrë të fthillimit(interpretimit) të bazuaranë :

1.Idetë e <<Njohësve të së Vërtetes >>(Hakikat)që kanë ndjekur udhën e Sufizmit (taçawwuf) dhe i kanë bërë të njohura zbulimet e tyre në saje të metodave të tyre të ndryshme.

2.Idetë e hoxhallarëve, të cilët e kanë quar jetën duke e adhuruar një <<zot diku largë>>dhe i kanë nxitur njerëzit të veprojnë po kështu, duke u munguar_dija shkencore, kulturore dhe thellësia e njohjes, të fituara nga Sufizmi. Duke qenë se i

kushtojnë rëndësi vetëm botës fizike dhe për ata, gjithçka mbetet në kufijt e përkapjes së organeve të tyre, ate çka mund të shohin sytë e tyre dhe të dëgjojnë veshët e tyre, nuk mund t'a tejkalojnë këtë nivel për të vlerësuar botën tejmateriale dhe thjeshtë mendojnë se qenja njerëzore, është një fizik(trup) nga mishi e gjaku dhe një shpirt, që i është dhënë më pas.

Grupi i parë tashmë e ka kuptuar kumtin e të Dërguarit t'ALL'LLAHUT, i cili na thotë se **"trupi juaj është shpirti juaj e shpirti juaj është trupi juaj"** dhe e kanë kuptuar se njeriu është një qenje ideore ose qenje përtej fizikës dhe shpirtërores. Më pastaj kanë kuptuar se tërë ekzistenca i përket **Vetëm <<ALL'LLAHUT>>** dhe e kanë zbatuar këtë njohje në praktikë.

Përveç tjerash, duke e kuptuar se **tërë ekzistenca nuk është gjë tjetër veçse një mashtrim(iluzion) dhe se ndarja individuale nuk është tjetër veçse një prodhim i vet veçorive të vëzhguesit, ata kanë shpjeguar se<<gjithësitë rrjedhin nga një përfytyrim>>.**

Ata kanë kuptuar poashtu që cilësitë e tëra të të gjitha qenjeve njerëzore ndodhen në çdo pjesëz (çdo pjesëz-thërmi përfshin tërsinë e tipareve të të gjitha qenjeve), duke i pohuar kështu fjalët e të Dërguarit t'ALL'LLAHUT, 14 shekujmë parë, kur thotë se **<<një grimcë(thërmi) përmban Tërsinë.**

Ku gjendet shkenca perëndimore pas 14 shekujsh?

Në fillim të shekullit XIX-të, studimi i materies së fortë, në thellësi ka treguar se përbëhej nga atomet. Mirëpo sot kuptohet se ajo që është konsideruar si materie, në të vërtetë nuk ekziston, dhe si pasojë e aftësisë përkapëse të vështruesit

ose pikëvështrimit tij, bota e atomeve të ndërlidhura duket si botë e individëve të ndarë dhe e substancave materiale të ngurta.

Tash vonë është vërtetuar, nga Doktor Karl PRIBRAM, neuropsikolog në Universitetin e Stanfordit (i drejtuar tash nga Qendra Neurologjike e Radfordit), se qelizat e trunit ishin qendra interpretimi frekuencash të ndryshme dhe se truni funksiononte sipas parimit të një hologrami.

Paralelisht, fizikanti, David Bohm, nga Universiteti i Londrës, njeri i favorizuar i Ajnshtajnit, ka zbuluar, me rastin e hulumtimeve të tij mbi **fizikën e kanteve** që struktura e gjithësive ishte e njëjtë me këtë të një **hologrami**. Të gjitha këto zbulime janë rigrumbulluar në një libër të botuar nga Micheal Talbot.

60

Zbulimet e këtyre hulumtuesve na njoftojnë me sa vijon :

Truni ynë ndërton matematikisht njëmendësinë objektive duke interpretuar frekvencat, që nuk janë gjë tjetër, vetëm projekte nga një përmasë tjetër, një rend (rregull) ekzistence më i thellë që qëndron mbi hapsirën dhe kohën.

Për Pibramin, kjo sintezë ka bërë që ai të jetësojë **se bota objektive nuk ekziston, së paku ashtu siç ne e kemi zakon t'a besojmë**.

Ajo që ndodhet<< atje jashtë >>, është një oqean i madh valësh dhe frekuencash, e truni ynë mbledhë informata abstrakte nga ky oqean pastaj i kthen në objekte te njohura që e përbëjnë botën tonë të zakonshme. Ne kemi shqyrtuar ketë temë në hollësi në librin tonë të titulluar <<UDHËTIMI DREJT HËNËS>>.

Vazhdon.....

Ka kohë, Evliat e ALL'LLAHUT që e kanë arritur njëmendësinë përmes gjendjes <<kashf>>dhe <<fatih>>, kanë mbajtur të njetin qëndrim lidhur me njëmendësinë e kësaj bote :<<Gjithësitë n'origjinë nuk janë gjë tjetër vetëm një përfytyrim (njëmendësia e gjithësive s'është gjë tjetër veçse një përfytyrim i kulluar)>>.....Vetëm ALL'LLAHU është që ekziston dhe gjithçka tjetër është vetëm hija e TIJ.

*Dy konstatime mbi njëmendësinë e botëve puqen, njera që buron nga zbulimet e shkencës bashkohore ku koncepti i <<materiales>>bile nuk është respektuar....tjetra nga **Sufitë islam** të cilët i kanë përmend këto njëmendësi shumë para të parve!*

61

Megjithatë, të shumtë janë udhëheqësit shpirtëror musliman(!) të cilët edhe sot nuk kanë as më të voglën njohje bile mbi këtë fakt dhe përpiqen t'a kuptojnë jetën përmes një perspektive materialiste, e kufizuar në përmasën fizike.

*Këta muslimanë materialistë, duke mos i njohur thellësitë dhe gjendjet dimensionale, mundohen të gjejnë shtatë shtresa qiellore me të dëgjuar për"shtatë qiejt"në ngritjen (**Miraxhin**) e të **Dërguarit**, duke menduar se i **Dërguari i ALLAHUT** ka fluturuar nepër shtatë qiej dhe ka takuar një zot atje lartë dhe nuk e kuptojnë fare se"qiejt" janë në të vërtetë karakteristikat e brendshme të përmasave subatomike. Këta muslimanë materialistë po përpiqen t'a kuptojnë <<**Dinin ISLAM**>> duke u mbështetur në shtatë shqisat*

*Janë vëllezërit e mij të shtrenjt musliman të pafajshëm, të cilët **metaforat** i kuptojnë si vet <<njëmendësia-realiteti>>, (**hakika-t**)pastaj e kërkojnë njëmendësinë në <<metafora>>!*

Ne duhet t'arrijmë të shgarkohemi nga <<**Islamizmi**>>, i cili mbështetet në konceptin e një<< zoti >>i cili gjendet atje lartë, larg nesh, koncepti i cili është zhvilluar nën ndikimin e filozofisë materialiste ; ne duhet bëjmë që t'arrijmë deri tek të kuptuarit e njëmendtë të <<**Dinit Islam**>> duke qenë **SISTEM, REND(RREGULL)** i përgjithshëm i **ALL'LLAHUT**, dhe t'a zbatojmë një të kuptuar të tillë. Së këndejmi ne duhet të pastrohemi nga çdo shtrembërim që na ka burgosur deri këtu nepër fshikëza.

Të përpiqemi të bëjmë një krahasim ndërmjet zbulimeve të fundit shkencore dhe perspektivës dhe mënyrën e të menduarit, të shpjeguar në veprat e **autorve sufij, që e kanë arritur të Vërtetën**, kanë arritur t'i kuptojnë dhe t'i zbulojnë misteret e <<**Dinit ISLAM**>>.

62

Dhe më në fund të përpiqemi të kuptojmë sa më mirë që të mundemi se çka do të thotë **Feja nga këndvështrimi ALL'LLAHUT**, në dritën e këtyre të dhënave.

Ajeti parëqë i është shpallur të Dërguarit t'ALL'LLAHUT është <<**ikree!>>I Dërguari i ALL'LLAHUT dhe Kur'ani** porosisin qenjet njerëzore <<**të fitojnë njohuri**>>! Hadithi vijues <<**Besimtari kërkon urtësinë-diturinë kudo që ta gjejë**>>na tregon se shkenca<<**ilm**>>, nga cilatdo burime që vjen ajo, duhet të çmohet.

Qëndroni m'anash atyre që ndalojnë pyetjet?

Qëndroni m'anash atyre që ndalojnë shkencën dhe imponohen në tabu!

Ju nuk do të ktheheni kurrë në këtë botë dhe ju kurrë nuk do të keni më rast të fitoni dituri shkencore, nëse ju nuk e bëni këtë herë!.

*Është e pamundur të kuptohet dhe të vlerësohet-çmohet <<Dini –ISLAM>>me një çasje materialiste, formale, e kushtëzuar, thjeshtë duke imituar të tjerët, siç e kemi zakon t'a bëjmë. **Njohja është një detyrë (farz)për çdo muslim**, dhe ajo duhet të fitohet me të kuptuar e jo përmendsh.*

*Është vetëm një mënyrë për t'a arritur : të jesh **fundamentalist!** Dhe **UNË JAM NJË FUNDAMENTALIST!***

* * *



UNË JAM NJË FUNDAMENTALIST

64

Po pyetem, nëse e kini vërejtur se <<unë jam një fundamentalist>>.

*Paraqitja ime e jashtme (**zahir**), së cilës i përmbahem, kjo e njëmendësisë së Muhammedit (Resul-all'LLAH).*

*Ana ime e brendshme (**batin**) ngritet deri tek Njëmendësia **absolute(ALL'LLAH)**.*

*Islami, <<Fe e shpallur nga ALL'Ilahu>>, është Dini im (feja ime).Folja prej **ALL'LLAHUT(kelam-ALL'Ilah)** është Libri im.*

*Jam vetëm një lexues dhe një shkrimtar! Po e lexoj Librin e <<**ALL'LLAHUT**>>aq sa mundem.*

Po përpiqem t'a shpjegojë Dinin të shpallur nga ALL'LLAHU në përpjestim me shkallën e të kuptuarit që mund t'a arrijë dhe ashtu siç ishte urdhëruar.

*Brendësisht, ekzistenca ime i takon **ALL'LLAHUT**. Dhe jashtësohem kur u drejtohem njerëzve.*

Përulem (bie në sexhde)para ALL'LLAHUT, Zotit të Gjithësive dhe jam i vetëdijshëm se nuk përfaqësoj <<asgjë>>në gjirin e SISTEMIT.

Jam i nderuar të jem rob i **TIJ**. Veprimtaria ime në shërbim të njerëzimit dhe për këdo që të jetë, pa dallim, është dhurata më e mirë që më është dhënë.

Nuk kam të drejtë as të gjykojë, as t'a vlerësojë as edhe t'a urdhërojë këdo, jo më shumë sa s'është as detyrë e imja t'a bëjë këtë, prej çastit që jam një rob i **ALL'LLAHUT <<abdu-LLAH>>!**

Rregullat dhe urdhërat janë prej **ALL'LLAHUT**, Zotit të gjithësive.

65

Po.....unë jam një **fundimentalist!**

Detyra ime është t'ua përhap të gjithë njerëzve vërtetësitë e sjellura nga i **Dërguari i ALL'LLAHUT.....** Dhe ç'atëherë unë kryej detyrën time!

Sepse unë jam një fundamentalist dhe i shmangem sipërfaqësorës.

I përmbahem ajeteve vijuese : <<Kujtohu, se kjo është detyra yte e vetme;ti nuk ke të drejtë mbi ata(të ushtrosh kurfar force)!>>

Po dëgjoj, po lexoj dhe po përfitoj maksimalisht nga mësimet e pasardhësve të të Dërguarit **t'ALL'LLAHUT**. Megjithatë, burimi im i vetëm i pakushtëzuar është Libri i **ALL'LLAHUT (kitab-ALL'LLAH) dhe ResulALLAHU!**

Jam i dashur me të gjithë, pa dallim dhe duke qenë në shërbim të cilitdo, s'bëj tjetër, vetëm përmbushi detyrën time ;

pavarsisht nga zgjuarsia e tyre, rruga që ndjekin, raca, kombi. Ndryshe unë jam një fundamentalist!

Dini -ISLAM, i shpallur nga ALL'LLAHU, është **Dini im....Ç'atëherë, besimi im (imani)s'është tjetër veçse bindja ime!**

Po....unë jam një <<**fundamentalist**>>!

Shikimin tim, vështrimin tim, ia detyroi Atij që shef (**El – BASIR**)! Sepse pa dashjen e TIJ, nuk do të mund të shifsha. Dëgjimin tim ia detyroj **ATIJ** që dëgjon krejt (**Es-SEMI**). Pa dashjen e TIJ nuk do të mund të dëgjoja. Aftësinë fjalëve dhe shkrimeve të mija ia detyroj **ATIJ** që flet (El-Mutekellîm), njohja ime, << në saje të Ndihmës-Vullnetit TIJ(luft) dhe vendimit TIJ.

66

I Dërguari i ALL'LLAHUT (Resul-ALL'LLAH) ka ardhë me qëllim që t'u shpjegojë njerëzimit mbarë njëmendësinë e jetës në këtë botë si dhe njëmendësinë e botës përtejme dhe e ka kryer plotësisht detyrën e tij.

Unë jam një **fundamentalist >>!**....Po e ndaj me të gjithë atë që mësova nga I Dërguari i ALL'LLAHUT.Tjerat nuk janë në kompetencën time-nuk më përkasin mua. **Unë nuk ushtroj kurfar shtypje mbi këdoqoftë që t'a respektoj këte ose atë praktikë ose të pranoj çkadoqoftë! Unë jam një fundamentalist!...**

Unë e di ku e kam vendin. Nuk jam kurfar pionieri, as lider as hoxhë ose mjeshtër **apo** sheik, unë vetëm ndaj me të tjerët njohjen time, ngase jam një robi **Tij** dhe nuk më përket mua të shërbehem me **autoritetin e TIJ.**

Më në fund, siç kam thënë më sipër, unë jam një fundamentalist.

*Dij dhe po përpiqem të dij ajo që është më e çmuara në botë dhe është shkruar në **Kitab-ALL'LLAH**. Dhe po aq e çmueshme është të jesh i zoti t'a Lexosh, t'a kuptosh dhe t'i nënshtrohesh kërkesave të tij. Ashtu siç e di dhe ua kam bërë të njohur, kjo do t'u mundësohet vetëm atyre, që ka dasht **ALL'LLAHU** dhe të cilëve **AI** ua ka lehtësuar punën. Ja përse nuk e gjykoj asnjëri që ka gabuar, që ka mangësi dhe dobësi..... Duke qenë se çdo gjë është vendosur nga Krijuesi, nuk do t'insistoj në këtë.....*

*Nuk jam këtu për të qortuar, por për më tepër për t'a ndarë njohjen time....Ja përse jam një <<**fundamentalist**>>autentik dhe i sinqert. Dëshiroj nga thellësia e zemres që **ALL'LLAHU** t'ia mundësoj secilit t'arrijë <<**bazat e Din-it**>>, t'a kuptojë **SISTEMIN e ALL'LLAHUT** në mënyrë që të përgatis për mrekulli hyrjen në Xhenet!*

*Më falni nëse po shprehem në veten e parë <<unë>>, ngase kjo është një domosdosi e shprehjes. Siç kam thënë tashmë, jam njoftuar dhe jam i vetëdijshëm se gjithmonë jam **ASGJË!**>>.*

Më në fund, <<lexova >> Librin e ALL'LLAHUT(Kitab-ALL'LLAH) sikur edhe qe vendosur kjo për mua!

<<Të Lexosh>>! Lexo **Çka**, të nesërmen?

* * *



Ç'FAR KA LEXUAR MUHAMMEDI

68

Ne duam që t'argumentojmë, por ne nuk duam t'a hulumtojmë të vërtetën, ku do të bazoheshin argumentet tona! Shumica syresh mbështeten në të dëgjuara vesh më vesh, në njoftimet e mara andej –kënde! Ne bile as që shqetësohemi nëse idetë dhe fjalët tona janë ose nuk janë të logjikshme, t'arsyeshme, të urta (të mençura)....!

Tash do të doja t'ua tërheq vëmendjen mbi një çështje, vërtetësin e së cilës ne kurrë nuk e kemi kërkuar njëmendësisht.

Nëse Pejgamberi Muhammed alejhiselam ka qenë i arsimuar(ka ditur shkrim-lexim)?

Ç'far ka “LEXUAR” Muhammedi Alehiselam?

Të ndarë, në dy grupe, për shkak të bindjeve të tyre të ndryshme, ata me shekuj u janë shtruar zënkave, rreth bindjeve se ka qenë i arsimuar ose analfabet Pejgamberi Muhammed alejhiselam, se ka ditur shkrim-lexim ose jo!

Disa pohojnë se nuk ka ditur të lexojë, ka qenë analfabet, pra <<Ummi>>. Të tjerët mbështesin mendimin e kundërt. Sidoqoftë <<Ummi>>do të thotë krejt diçka tjetër.

Përpiquni për një çast të mendoni periudhën kur ka jetuar Muhammedi...

A ka marr diç të shkruar Pejgamberi Muhammed Alejhiselam në duart e tij, kur Xhebraili ju ka drejtuar atij kështu : <<lexo>> (ikre)!

Sigurisht që jo! Asnjë tekst i shkruar nuk i është dhënë të Dërguarit të ALLAHUT!

Pasiqë Pejgamberi nuk ka marr kurrë tekst të shkruar, atëherë si mund të përkrahet mendimi, nëse ai ishte i arsimuar ose analfabet?

Është një pikë tjetër e rëndësishme së cilës ne duhet t'i kushtojmë kujdes :

Ç'far shenjonte ajeti <<LEXO>>, çka duhej <<LEXUAR>>, meqë asnjë tekst i shkruar nuk i është dhënë **Resul-ALLAHUT?**

T'a shqyrtojmë shkurtimisht këtë çështje, meqë ishte objekt i një studimi të veçant në librin tonë të titulluar <<Ç'far ka lexuar Muhammedi>>...

Fjala <<LEXIM>>ka për bazë dy kuptime : Njera do të thotë <<të kuptojmë ate që shofim duke u mbështetur në shikim...>>, tjetra << të vlerësojmë (caktojmë)atë që shofim duke u mbështetur në vështrim>>.

<< Me Shique>> dhe <<me pa>> janë dy terme të ndryshme që dallojnë njera nga tjetra. Secili mund të <<shikojë>>mirëpo janë të paktë ata që janë të zotët të <<shofin>>!

<<Basar>> (syri si organ) për të parë, por <<basiret>>(syri përkapjes)shoh!

Kjo do të thotë se analiza e asaj çka shohim, duke vlerësuar dhe shpjeguar kuptimin e saj, është domethënja e njëmendtë e të <<parit>>.

Ju mund të dëgjoni diçka. Mirëpo ju keni nevojë për një mendje të fuqishme, aftësi të të gjykuarit dhe të kuptuarit që të jeni në gjendje të kuptoni dhe të vlerësoni se çfarë keni dëgjuar. Poashtu <<me pa >>nga ajo që keni shikuar është një aftësi tjetër! Këtu <<lexim>>do të thotë jo vetëm të ç’kodoni(të zbërtheni)dhe të analizoni një tekst të shkruar që ju e keni parë, por edhe të <<shifni >> **ate që keni vështuar dhe <<vlerësuar>> vështtrimin duke zbuluar kuptime të reja në sajë të një mendjeje të fuqishme dhe aftësisë të të gjykuarit....**

70

Si do t’a kuptojmë ne formulën <<LEXO>>me të cilën meleku **XHIBRIL** i është drejtuar **Pejgamberit Muhammed**, meqë këtu nuk është fjala mbi <<leximin>> e një teksti të shkruar?

Ne do të përpiqemi t’i ilustrojmë fjalët tona me shembullin vijues :

Komentatorët e sportit, kritikët e sportit shpesh përshkruajnë disa veçori të trajnerve të skuadrove me këto fjalë :<< Trajneri ishte i pakujdesshëm, ai nuk arriti t’a lexonte lojën....lose <<trajneri e lexoi shumë bukur gjysëmlojën e parë, dhe strategjia e tij e tij qe e suksesshme për skuadron e tij në gjysëmlojën e dytë!>>.

Kështu, të<<lexosh>> një tekst të shkruar, do të thotë njehërit të<<kuptosh>>përmes vështtimeve tona ate, **pse -hin, si-n** qëllimin që e bartë >>.

Së këndejmi, formula <<**LEXO**>>drejtuar Pejgamberit Muhammed Alejhiselam, ishte një urdhër që ai t'a **LEXONTE SISTEMIN RENDIN** që e krijoi ALLAHU.

Këtu, duhet t'a zgjedhim njerën nga dy mënyrat e të drejtuarit <<**LEXO**>>:

1. Ose kjo ka të bëjë me një urdhër që i drejtohet Pejgamberit Muhammed Alejhiselam, dhe vet atij, që do të thotë se nuk n'a përket neve dhe se nuk është punë e jona të <<**lexojmë**>>! Në këtë rast do t'ishte e pakuptimt përpjekja që të kuptojmë se çfar kanë bërë të njohur **Kur'ani dhe Resul-ALLAHU!** Ne na përket vetëm t'a kryejmë verbërisht dhe pavetëdijshëm ajo që kërkohet prej nesh, si një kafsh e zbutur.....

2. Ose... ky urdhër i drejtohet përgjithsisht <<yymetit>> të Pejgamberit Muhammed Alejhiselam me ndërmjetësimin e tij. Që do të thotë se të gjithë pasuesit e Pejgamberit Muhammed duhet të <<**LEXOJNË**>>! Kështu, është detyrë e të gjithë besimtarve t'a <<**LEXOJNË URDHËRIN e ALLAHUT, SISTEMIN e JETËS që KRIJOJ ALLAHU...**>>

Ne duhet t'a konsiderojmë këtë seriozisht dhe t'a kapim kuptimin si duhet....

Çfar **SISTEMI** ne duhet t'a <<lexojmë>>?...Kjo do të jetë tema jonë e rdhshme Insha-ALLAH!



<<LEXIMI SISTEMIT>>

72

*Në kapitullin paraprak ne u përpoqëm t'ua shpjegojmë domethënjen e fjalës <<lexim>>. Tash ne do të përpiqemi të sjellim qartësi mbi **SISTEMIN** që duhet t'a **LEXOJMË**....*

Ne këtu jemi mbi tokë me cilësi të ndryshme që dallojnë nga individ në individ, ndaj edhe zgjidhja i shpëton kontrollit tonë dhe dëshirave tona.

Ne nuk kemi zgjedhur as vendlindjen tonë, as racën, as familjet tona, as prindërit tonë, hiq më shumë se gjininë tonë. Jemi angazhuar në një garë, që pa dyshim, ka filluar në mëyrë të pabarabartë.

Në kundërshtim me të kaluarën tonë të pandryshueshme dhe prejardhjen tonë, ne ndodhemi përball një të ardhme, rrjedhën e së cilës mendojmë t'a ndojmë sipas qejfit tonë.

Në SISTEMIN që e krijoi ALLAHU dhe që ne zakonisht e quajmë <<natyra>>, nuk ka vend për ndjenja...

Pasi që luani t'a ketë rrëmbyer një gazelë ose një buf, ai fillon t'a copëtojë dhe t'a gllabërojë ate, derisa ato janë ende gjallë,

pa as më të voglën dhembëshuri, përkundër rezistencës dhe britmave të viktimës.....

Sado që të kërkoni falje, për gotën e thyer, e cila ju shpëton nga dora, doemos ajo do të thehet kur të bije mbi një sipërfaqe të mermert.

I fuqishmi shtyp gjithnjë të dobëtin!...

Ndonëse nga një anë ne shprehim dhembjen tonë për kafshët e therura me rastin e Kurban Bajramit, n'anën tjetër ne nuk largohemi fare nga mishtoret. Ne nuk e përfillim një drekë pa mish, edhe pse nuk na mungon as pula ose qingji për darkë. Duke shkuar në peshkim, gjoja të zhgarkohemi nga shqetësimi, ne ndjejmë kënaqësi kur t'i mbytur (kapur) peshqit e detit.

73

Ç'është e vërteta, ne jetojmë në një SISTEM, në një REND, ku i fuqishmi asgjëson të pafuqishmit, dhe më i forti gllabëron të dobëtin. Kjo bëhet, në të gjitha fushat, në të gjitha përmasat dhe në të gjitha nivelet e jetës!.....

Ja në një kësi SISTEMI, në një REND të këtillë, Resulul-ALLAHU, Pejgamberi Muhammed është përpjekur t'a komunikojë dhe t'ua bëjë njerëzve të kuptueshme të vërtetën e padiskutueshme, me sa vijon :

Nuk ka zot larg qenjeve njerëzore, nga botët dhe nga yllësitë, ka VETËM ALLAH, që me shkencën (ilmin) e TIJ, ka krijuar çdo gjë që nga cilësitë e Emrave të Tij më të Bukur (Esmayl-Hysna)! Së këndejmi, çdo përpjekje në adhurimin e një zoti të tillë është e kotë. NJË sjellje (qëndrim i) e tillë shpie çdo herë në mosnjohjen e së <<Vërtetës>>.

Në Sistemin e <<ALLAHUT>> njeriu duhet të formohet në dy aspekte :

1.- Në njohjen e ALLAHUT si njëmendësi e vet njeriut(hakikat).

2.-Në përgatitjen për jetën e pas vdekjes duke i kryer rregullisht praktikat(ibadetet) që t'i jetësoj cilësitë që nuk i kishte.

Sistemi funksionon në bazë të parimit sipas të cilit secili i jeton efektet natyrore të vet ndërtimit tij dhe vet aftësisë tij.

Secili përballet dhe ngarkohet me rezultatet e vet veprimeve të veta! Ky është rregull në sistemin e ALLAHUT.

<<Kushdo që të kryej një vepër të mirë, qoftë edhe sa një grimcë, ate edhe do t'a shoh >>.

74

<<Kushdo që të bëjë keq qoftë edhe sa një grimcë ate do t'a shoh>>.

Me fjalë të tjera, ata që përgatiten për jetën e pasvdekjes do t'i shpëtojnë vuajtjeve të këtij mjedisi. Ata që nuk janë përgatitur për këto kushte, do t'i heqin pasojat e saj.

I Dërguari i ALLAHUT, ka paralajmëruar njerëzit mbi kushtet e jetës së pasvdekjes dhe i ka njoftuar mbi domosdon që të përgatiten.

Njerëzit kanë nevoj të përgatiten për jetën e pasvdekjes duke i kryer disa nga ibadetet, jo me qëllim të çfaridoqoftë adhurimi, por t'i nënshtrohen SISTEMIT të krijuar sipas rendit t'ALLAHUT.

Ja pse ne para së gjithash duhet të mësojmë dhe të kupojmë se çka është SISTEMI, rendi ALLAHUT, që e quajmë <<DIN>>!
Dhe kjo me qëllim që të kuptohet se çfar fshihet prapa këtyre këshillave(porosive), dhe të mos i shpërfillim ibadetet me një rëndësi vitale.

Duhet të dijmë se të gjitha praktikat(ibadetet) e këshilluara me <<Din-in Islam>> janë të bazuara mbi një arsyetim teknik, shkencor dhe kjo tregon menjëherë rezultate. Asnjë nga këto këshilla nuk vijnë nga lartë.

Praktikat islame(ibadetet) janë detyra të këshilluara sipas SISTEMIT. Prandaj, ne tash e tutje duhet t'a kuptojmë ME GJITHË MEND SISTEMIN, RENDIN E KRIJUAR NGA<< ALLAHU >>

Të ndjekim kapitullin vijues:

* * *



<<DIN-I ISLAM>> SHPJEGON <<SISTEMIN>>

76

Miqt e mij...përpikuni të jetësoni njëmendësinë e dukshme që ju shpëton për shkak të mënyrës së çasjes suaj të kushtëzuar të fesë.....

Feja Islame, e tillë siç u shpall në formën e saj të parë fillestare, ka ardhë me qëllim që t'a shpjegojë SISTEMIN E JETËS dhe rendin si edhe për të na njoftuar mbi pasojat e veprimeve tona. Nën këtë SISTEM secili do të bartë rezultatet e vet veprimeve të veta.

Qofshim ne të vetdijshëm ose jo, tërsia e regullave dhe parimeve të ashtuquajtura <<ligje të natyrës>> përfaqësojnë SISTEMIN E ALLAHUT. Ata që nuk i përmbahen si duhet këtyre ligjeve do ti heqin pasojat e kësaj shpërfilljeje.

Ajeti kur'anor në vijim thotë mbi këtë fakt :

<<We –jetefekkerune fij halkissemavati vel ard>> që do të thotë : <<Ata persiasin mbi krijimin e qiejve dhe të tokës (me të menduar).

Ky ajet shenon se njerëzit e mençur dhe të zotët e mendjes, duhet t'a çmojnë krijimin në mënyrë që të mund t'a njohin dhe t'a kuptojnë Sistemin dhe Rendin e ALLAHUT. Ka shumë ajete të tjera të këtij lloji në Kur'an që i kurajojnë njerëzit në përpjekje të të kuptuarit të Sistemit t'ALLAHUT duke vlerësuar gjithnjë sistemin e jetës aktuale.

Ja mbi këtë njëmendësi të SISTEMIT mendonin urtakët e moçëm kur thoshin :<<Do të korrësh atë që ke mjellur >>ose <<kush mbjell erën korr stuhinë>>!

Siç thash më parë, ju do të shpërbleheni vetëm për vet veprimet tuaja, qoftë në jetën e kësobotshme, qoftë në atë të pasvdekjes!

<<Kurfar pasurie nuk do t'i bëjë dobi njeriut, pos vet veprat e tij>>(53:39)

Ky ajet po kështu tregon qartë se.....

Nuk ka një zot diku largë prej vet jush që do të ju dënonte për shkak të përluljes ose shpërfilljes suaj.

Nëse ju do t'i plotësoni kushtet që ju porositi Resul-ALLAHU si një domosdosi për jetën e pasvdekjes, ju do të përfitoni pastaj nga SISTEMI ALLAHUT.

Nga ana tjetër, nëse ju nuk do t'i përmbaheni këshillave(porosive) të Kur'anit dhe të Resul-ALLAHUT, ju do t'i vuani pasojat e shpërfilljes së SISTEMIT dhe të Rendit të ALLAHUT.

<< Ne ua tërhoqëm vërejtjen (idhujtarëve) për një dënim të afërt, në ditën kur njeriu (besimtar)shikon se çka i kanë sjellë duart e veta dhe jobesimtari thotë :<<Ah sikur t'isha dhë!>>(78:40).

<<Sot pra askujt nuk i bëhet e padrejtë diçka dhe nuk shpërbleheni për tjetër vetëm për atë që vepruat.>>(36:54)

<<Dhe nuk ndëshkoheni për tjetër përveç për atë që vepruat>>.(37:39).

Në ajetet e sipërpërmendura kuranore, që i morëm si shembull, theksi vihet mbi këtë fakt :

Besimi juaj në një zot që ju vështon nga lartë dhe ju gjykon për veprimet e bëra ; pasi nesër të ketë sjellë vendimin e marr, është i pakuptimt! Një botëkuptim i tillë fetar i mbështetur mbi një besim të tillë është i pabazë dhe i pavleftshëm.

<<<ALLAHU>> , me dijen (shkencën) e TIJ ja ka caktuar qëllimin e sakt çdo gjëje që e ka krijuar, në një SISTEM, REND të caktuar, me qëllim që njerëzit t'a njohin punën e këtij SISTEMI, Këtij Rendi, përmes Resulit TIJ, dhe këshillon njerëzit të jetojnë nën mbrojtjen e ligjeve të TIJ në mënyrë që t'i evitojnë pasojat e pakëndshme në jetën e pasvdekjes, si rrjedhim i mosrespektimit të këtij Sistemi....

Ne ose do t'a kuptojmë këtë SISTEM, duke kryer me respekt atë që na këshillohet, për t'a drejtuar ardhëmërin tonë kah Xhenneti...

Ose ne nuk do t' i kushtojmë kurfar rëndësie praktikave fetare(ibadeteve) duke përvetësuar <<Din-in>> në një sërë paragjykimesh, thash e themesh, marrëzive, përfytyrimeve të kota, pra duke e drejtuar ardhmërinë tonë kah Xhehenemi, për t'i vuajtur pasojat e dhëmbshme.

Të përpiqemi tash t'i kuptojmë parimet e këtij SISTEMI dhe të diskutojmë mbi logjikën dhe urtësinë e DHIKRIT, Namazit e

haxhit, të cilat janë këshilluar me Dini-Islam, sa më mirë që të mundemi.

Artikulli ynë i ardhshëm do t'i kushtohet <<Insha-ALLAH >>fursionimit të trunit dhe DHIKRIT.

* * *

18



TRUNI DHE DHIKRI

80

Ne jemi përpikur t'a shpjegojmë faktin vijues në hollësi në librin tonë titulluar <<DUAJA dhe DHIKRI>>.

Duaja (lutja) sikur edhe DHIKRI(përsiatja me ndihmën e Emrave t'ALLAHUT) janë praktika, qëllimi i të cilave është të shtojnë veprimtarinë e trunit dhe t'i ndihmojmë atij(pra trunit) t'i shpreh cilësitë dhe forcën, me të cilat e pajisi ALLAHU.

Përveç tjerash, këto praktika (ibadete), ndihmojnë individin t'a ndërtojë trupin e vet për jetën e pasvdekjes.....

ALLAHU me Shkencën e Tij, ju bëri të qenësishëm me Emrat e Tij më të bukur. Prandaj, truni juaj fsheh të gjitha tiparet që marin kuptimet e attributeve t'ALLAHUT.

Kur ju t'i përsërisni pa pra Emrat e ALLAHUT në mendjen tuaj, ju i ipni shtytje trunit tuaj që t'i zbulojë kuptimet e tyre.

Për shembull kur ju të përsërisni Emrin <<Myrîd>>, që është cilësi e ALLAHUT <<VULLNET>>, sa e sa herë, për shembull tre mijë në ditë, ju qartë do të vëreni një përmirsim të

konsiderueshëm të vullnetit tuaj. Ju do të habiteni se me çfarë aftësie do t'i zbatoni shumicën e punëve tuaja pa përpjekje të madhe, derisa ju nuk arrinit më parë në mungesë të vullnetit tuaj.

Nëse ju përsërisni Emrin e ALLAHUT <<Kuddus>> pas emrit <<Murîd>>aq herë në ditë gjithnjë duke e zbatuar lutjen <<Kuddus'ut tahiru min kulli sûin>> treqind ose gjashtëqind herë në ditë, ju thjeshtë do të pushoni të pini duhan, alkohol, ose të merni drogë, pa far zori. Ju do të pyeteni nëse tërë kjo është njëmendësi ose nëse këto praktika janë vërtetë të nevojshme! Proveni dhe shihni vetë! Vetëm se duhet t'i zbatoni gjatë disa muajve dhe ju do t'i shifni atëherë arritjet ndonëse ju nuk besoni njëmend në efikasitetin e tyre.

81

Sepse zbatimi i DHIKRIT është një ecuri krejtësisht teknike ; prandaj t'i përvetësoni këto mirësi nuk mvaret fare nga çfardoqoftë besimi. Ne e kemi vëzhguar këtë në një shumësi përvojash.....

Kështu, shumë njerëz kanë heqë dorë fare lehtë prej shumë shprehive pasi që kanë zbatuar DHIKRIN, si ju kemi këshilluar tashmë dhe kanë ngulmuar në këtë praktikë, ndonëse deheshin nepër bare, thjeshtë për të provuar edhe pa u thënë ne fare....

DHIKRI është një praktikë që ka të bëjë me përsëritjen e fjalëve që marrin formën e kuptimit në tru. Nuk ka të bëjë as me kohën as me vendin e as me besimin.

Për herë të parë në Turqi, poashtu edhe nepër botë, ne kemi shpjeguar në librin tonë << MISTERET E NJERIUT >>, botuar me 1986, se DHIKRI ishte një SISTEM PRAKTIKASH, qëllimi i të cilit ishte të shtohet veprimtaria e grupeve qelizore në tru, duke ia nënshtruar kështu një list fjalësh. Një shpjegim më i

hollësishëm është në disponim në librin tonë <<Duaja dhe DHIKRI>> si dhe në librin <<ALLAHU i LAJMËRUAR NGA MUHAMMEDI>>.

Poashtu, zbulimet laboratorike kanë treguar që kjo praktikë e DHIKRIT, me përsëritjen e emrave në tru, shkaktonte shtimin e veprimtarive neurale në çastin kur rajone të reja dhe grupe qelizore ishin angazhuar në tru, botuar

për herë të parë në Dhjetor të 1993-shit në një artikull të revistës <<SCIENTIFIC AMERICAN>>, nga Xhon HORGAN.

Këto zbulime janë përfundime pas shumë vjet përvojash laboratorike të sipërpërmendura, përshkruar në këtë artikull që përfundon : <<Kur njeriu lexon një fjalë të re ose përsërit një fjalë të dhënë, rajone të ndryshme të trunit, poashtu edhe grupe qelizore jovepruese vihen në lëvizje dhe angazhohen në punë, në mënyrë që të rritet aftësia e trunit.

82

Aftësia e trunit tuaj zhvillohet njëkohësisht me përsëritjen sistematike të Emrave të dhënë t'ALLAHUT, disa herë. Dhe kjo ju ndihmon t'a zhviloni personalitetin tuaj në raport me Emrat e dhënë.

Pa mar parasysh nëse ju jini ose nuk jini besimtar! Sepse ky është SISTEMI, rendi ALLAHUT. Funksionimi i SISTEMIT, i Rendit të ALLAHUT, nuk mvaret nga besimi individit.

Arsyeja kryesore që ju ka shtyer të gaboheni në këtë çështje qëndron në faktin se ju nuk ishit të vetëdijshëm që në vetveten tuaj bartni Emrat më të Bukur t'ALLAHUT. Aq më tepër ju kini besuar, gabimisht, se duhet t'i kryeni praktikat (ibadetet)në drejtim të një zoti i largët prej jush!

Megjithate, Njohësit e së Vërtetës, që të gjithë, që nga Ahmed Jasevi, Jonuz Emre, Abdylkadër Xhejlani, Imam

GAZALIU, Haxhi Bektash Vali, Ibrahim Haki Erzurum dhe Mevlana Xhelaludin, kanë tërhequr vërejtjen në faktin se <<ALLAHU>> ishte vet Njëmendësia jonë dhe kanë ngulmuar në domosdon e njohjes së <<ALLAHUT>> në vet ne, në vend se t'i kthehemi një zoti largë vet –nesh.

Në të vërtetë, DHIKRI nuk është zbatuar për t'i pëlqyer një zoti larg jush, por më shumë që të zbulohet <<ALLAHU>> në vet qenësinë tuaj, duke rritur fuqinë tuaj mendore, dhe shkallën e të kuptuarit tuaj. Përfundimisht, DHIKRI ju ndihmon të jetësoni me të vërtetë Emrat më të Bukur t'ALLAHUT dhe të kuptoni <<misterin e kalifatit>> mbi tokë...

83 Nëse <<Duaja>> nuk është zbatuar me shpresë që të fitoni diçka, si kundërshpërblim, diçka nga ana e një zoti të largët, ç'është pra atëherë?

Ndjekim artikullin tjetër, insha-ALLAH...

* * *



DUAJA VALËT E DREJTUARA NGA TRUNI

84

Resul-ALLAHU thotë <<DUA-ja ËSHTË ARMA E BESIMTARIT>> (mu'min)! A jemi ne vërtet të vetëdijshëm mbi zbatimin e <<DUAS>>?

Ç'është <<Duaja>>dhe cila është dobia e saj? Meqë nuk ka zot largë jush, atëherë kujt i drejtohen lutjet tuaja (Duat)? Të përpiqemi tash t'ju përgjigjemi pyetjeve tuaja....

<<Duaja >> është veprim për t'i drejtuar valët e trunit!

T'i kujtojmë disa të dhëna që tashmë i kemi thënë.....

Sa i përket njëmendësisë(hakikat), njeriu s'është gjë tjetër vetëm një tërsi Emrash që i përkasin <<ALLAHUT>>...Domethënë, qenja njerëzore është një lloj formule e përbër nga kuptimet, e veshur me Emrat më të Bukura t'ALLAHUT. Me fjalë tjera, ALLAHU bëri njeriun Kalif të Tij, për T'a përfaqësuar në tokë, duke e stolisur(veshur) me Emrat e Tij më të Bukur.

Pas transformimeve të ndryshme, kuptimet e këtyre Emrave janë shfaqur në trunin e njeriut me urdhërin e ALLAHUT.

Sipas pohimit: <<Ju nuk mund të doni pa Vullnetin e ALLAHUT>>, Duaja juaj (lutja), në të vërtetë s'është gjë tjetër, pos një dëshirë e ALLAHUT.

Megjithatë, është një SISTEM, një REND, i vendosur nga ALLAHU, i njohur me emrin <<synnet-ALLAH>>. Ja që një dëshirë e tillë që buron nga Emrat më të Bukur t'ALLAHUT, ndonjëherë shprehet në formë <<Dua-sh>>edhe prej vet jush.

Ndonëse zakonisht, nën ndikimin e ideve materialiste, mendojmë se njerëzit bashkëbisedojnë me ndihmën e buzëve dhe të veshve, bashkëbisedimi, në të vërtetë është një lidhje ndërtrunore. Shpesh ndodhë që t'a ndjejmë, t'a përkapim një lidhje të tillë, por ne nuk mund t'a shpjegojmë logjikisht në mungesë të njohjes. <Intuita>> juaj është arritje e përkapjes suaj të brendshme të valëve....

<<Duaja>> rrjedhë nga Emrat e ALLAHUT (Esma-ALLAH). Është në qenësinë tuaj dhe vepron si një valë e drejtuar kah një qëllim dhe që arrin synimin e tij. Kështu, <<DUA-ja>>nuk është një kërkesë që del(buron) nga një ZOT i ndodhur jashtë vetes-suaj, por më shumë një dëshirë, zanafilla(burimi) i së cilës ndodhet në qenësinë tuaj.

Ju luteni, zbatoni <<Duan>> dhe kështu i drejtoni ndodhitë sikur kjo të jetë e shkruar në fatin tuaj. Në fakt nuk jini ju që drejtoni, por është AI-ALLAHU!

Sikurse që parazitët zvoglohen sa më shumë që njera nga dy hemisferat e globit tokësor gjindet në anën e kundërt të diellit, duke shkaktuar kështu një pranim më të mirë të valëve të shkurtëra, njësoj vlenë edhe për trunin njerëzor, i cili bëhet më i ndjeshëm dhe më i fuqishëm, sidomos duke filluar nga mesnata. Kjo vlenë si për pranim (frymëzim) ashtu edhe për

transmetimin(duaaja). Nata ka një rëndësi të veçant për <<Din-in Islam>>.

Ata njerëz që e shpërfillin zbatimin e <<Dua-s>>do të privohen nga çmuarja(vlerësimi) si dhe nga fuqitë e mundshme të qenësisë së tyre si dhe nga mirësitë që burojnë prej kësaj lutjeje.<<Duaaja >> është një ushtrim i fuqisë së ALLAHUT, që qëndron(jeton) në qenësin tuaj.

Fakti se i Dërguari i ALLAHUT është lutur aq shumë nuk do të thotë në asnjë mënyrë se ai ka kërkuar diçka nga një Zot i ndar prej tij(jasht tij), përkundrazi kjo tregon se ai e ka drejtuar fuqinë dhe forcën që jetojnë në vetveten e tij, por që i përkasinALLAHUT, drejt dëshirave të tij.

86

Sa më e fuqishme që të jetë aftësia e trunit tuaj, aq më të dobishme janë lutjet (Duat) dhe përkalimi mendor....

Ju përhapni tërsinë e mendimeve tuaja përmes tokës në përpjestim me fuqinë e trunit(mendjes)suaaj, jo vetëm në çastin kur ju bashkëbisedoni, por edhe kur ju mendoni. Këto frekuenca të pranuar nga mendje(tru) tjera, pranues përkatës, janë quajtur <<intuitë>>ose <<frymëzim>>. Ja në këso marrëdhëniesh disa njerëz shpirtëror-frymor të vertetë, të njohur në Sufizëm me emrin <<irshad kytub>> kanë një aftësi mbinatyrore. Ajo që shenjohej me marjen e fluksit (el-faydz Fajiz) s'është gjë tjetër vetëm një shtrirje mendore në saje të një përkalimi tjetër mendor të valëve të drejtuara. Ne kemi sjellë të dhëna më të hollësishme mbi këtë temë në librin tonë të titulluar <<DUAJA dhe DHIKRI>>, leximin e së cilës ne ua këshillojmë gjithsesi!.....

Në këtë kapitull, jemi përpjekur t'ua bëjmë të kuptueshme se <<DUAJA>>është mjeti më i dobishëm në jetën e njeriut. Dijeni se ALLAHU ju përgjigjet përmes vet jush. Fakti se është

në dijeni për të gjitha mendimet tuaja është rezultat i ekzistencës suaj me vet Ekzistencën e TIJ dhe manifestimin e Tij përmes vet jush.

Është mirë për çdokend që t'a zbatojë <<DUAN>>dhe të lutet rregullisht, pamvarsisht nga gjendja e tij shpirtërorre ose vetëdija e tij, siç bënte i Dërguari i ALLAHUT. Do t'a dijmë në jetën e pasvdekjes më qartë se asgjë nuk ka qenë më e frutshme se sa <<DUA-ja>> dhe namazet.

N'a e mundësoft ALLAHU t'a jetësojmë rëndësin e <<DUA-s>>, të na bëjë t'a duam, t'a çmojmë sa jemi gjallë aq sa të mundemi dhe të na e forcojë <<shpirtin>> tonë. Dhe ALLAHU n'a e lehtësoftë punën.

Lidhur me faktin se kah vijnë shpirtrat tonë? Nëse do ALLAHU ne do t'a shqyrtojmë këtë në kapitullin vijues.

* * *

20



SHPIRTRAT TONË A PASKAN QENË KRIJUAR NË TË KALUARËN?

88

Sot, do të dëshiroja të vë në dukje një mendim të gabuar me rëndësi të madhe:

<<Shpirtrat e njerëzve, a paskëshin qenë krijuar diku në të kaluarën që të dërgoheshin më pastaj mbi tokë një nga një?>>A është kjo ajo që na e bënë të njohur <<Feja>>sa i përket kësaj?

Sigurisht që jo!

Shpirtrat e njerëzve nuk patën qenë krijuar në të kaluarën e as nuk qenë dërguar mbi tokë njeri pas tjetrit në trupin fizik. Mirëpo, shpirtrat, kishin qenë formuar me trurin e çdo individi, në mitrën e nënës në ditën e 120-të të shtatzanisë, nën ndikimim e engjujve(melaikëve), si shprehje e fuqisë së ALLAHUT.

Kapitulli Lartësitë(Surja al-‘Araaf:172) në Kur’an na njofton me sa vijon :

<<Përkujto kur ZOTI Yt nxori nga shpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuës të vetes së tyre (duke u thënë): "A nuk jam ZOTI juaj,"(elestü Birabbiküm?). Ata thanë:"Po dëshmuam!" Të mos mund të thoni në ditën e Ringjalljes :”Ne nga ky(dëshmim)ishim të panjohur”>>.

Ky ajet duke qenë keqkuptuar, ka pësuar shpjegime të ndryshme, që nuk ka të bëjë fare me kuptimin e tij të mirëfillt. Në vazhdim, i kanë shtuar një sërë ndodhish të rreme, të pabaza, që marrë në përgjithsi, më në fund sot është pranuar nga njerëzit!

Ja shkurtimisht çfarë sjellë sot ky botëkuptim mashtrues :

89 <<ALLAHU krijoi shpirtat e qenjeve njerëzore, në një botë tjetër(gjithësi), të të gjithë njerëzve që duhet vijnë(të lindin) në jetën e kësobotshme, Ai do t’i pyet :<<A nuk jam unë ZOTI juaj?>> dhe këta shpirtëra do të përgjigjen :<<Po Ti je ZOTI ynë!>>. Pastaj, këta shpirtëra një nga një duke ardhur në botë, secili veç e veç hyn në trupin e vet përkatës fizik, gjatë shtatëzanis në mitrat e nënave të tyre. Po këta shpirtëra pastaj kthehen po kështu në botën e tyre fillestare(prej nga edhe kanë ardhur).

Për më tepër, sipas disa njerëzve të papërgjegjshëm, mendjelehtë, këta shpirtëra lëshojnë vendin e tyre për t’u kthyer në tokë sa e sa herë që t’arrijnë përsosurinë. Po këta individë përkrahin idenë e <<riinkarnimit>>që nënkupton rikthimin(e shpirtit) në këtë botë, për t’ u futur sërish në trupin fizik.!

Me qëllim që t’a arsyetojnë një botëkuptim të tillë, këta njerëz kanë shpikur një ngjarje tjetër të ashtuquatur “elest bezmi”sipas të cilit gjoja ata shpirta që janë njohur në botën e tyre fillestare, do të takohen sërish në këtë botë, ata që

janë dashur atje, do të vazhdojnë të duhen edhe këtu(në këtë botë) dhe ata që janë urejtur atje do të vazhdojnë të urehen këtu poshtë(në këtë botë!...

Tash, t'a shqyrtojmë shkurtimisht njëmendësinë e kësaj çështjeje dhe ne në vijim po japim provat tona.

<<ALLAHU>> është i Gjithëdijsmi, ja domethënjen e ajetit të sipërpërmendur :

Sipas pohimit se :

<<ALLAHU krijoi njeriun sipas natyrës së ISLAMIT >>çdo njeri lind sipas të dhënave gjenetike të bartura nga babai i tij në një program të <<ndërtimit islamik(fitrat), derisa ndodhej në formë sperme ; pastaj kalon nëpër etapa tjera....

90

Shprehja lidhur me <<veshkët si dhe paraardhësit(dhourriyya)>>shënon dhe ngulmon mbidisponueshmërinë e informimit sa i përket <<gjendjes(fizike)islame>> mbi mbartjen gjenetike në formë sperme. Domethënë që të gjitha qenjet njerëzore ishin pajisur me një dije natyrore që e bënë të vetëdijshëm mbi Zotin e tyre, ende në gjendje sperme, kur paraardhësit e tyre janë nxjerë nga veshkët.

Në të vërtetë, embrioni i pajisur me këte të dhënë gjenetike, fillon t'a ndërtojë trupin në jetën e pasvdekjes, që do të thotë <<SHPIRTIN>> e tij që nga dita e 120-të të shtatzanisë në mitrën e nënës, që paraqitet në formë frekuencash të prodhuara nga truni nën ndikimin engjëllor(të_melaikeve)....

Atëherë<<SHPIRTI>> grumbullon të gjitha të dhënat të prodhuara në formë valësh, që janë arritje e të gjitha veprimeve intelektuale. Prandaj teoria sipas së cilës shpirti do

të vinte nga një vend tjetër dhe do të futej në fizikun tonë është krejtësisht e papranuar.

Nëse ne e vërejmë mirë ajetin kur'anor të sipërpërmendur, që disa kanë dashur t'a imponojnë si një udhëzim se ekzistonte <<një botë e ndarë shpirtërore>> e krijuar plotësisht për jetët tokësore, në një vend tjetër, ne jetësojmë, se nuk ka asgjë prej kësaj, por se ka të bëjë me <<paraardhësit e nxjerrur nga brinjët e fëmijëve të ADEMIT>>. Parardhësit dhe veshkët janë në marrëdhënje me përmasën e botës sonë fizike në të cilën ne jemi tash dhe jo me botën shpirtërore. Veshkët janë konsideruar në raport me botën spermatozoide.

91

Ne kemi sjellë më shumë hollësi mbi këtë temë në librin tonë të titulluar <<Ç'far ka lexuar Muhammedi>>. Ju poashtu mund të gjeni më shumë të dhëna duke pohuar shpjegimet tona në vëllimin 4, faqe 2324 të interpretimit të Kur'anit në turqisht, nga Hamdi Yazir Elmali.

Në librin e tij të titulluar <<Rawdzatu Talibin>>, të ImamGAZALIUT, lidhur me këtë pikë thuhet :<<...Meqë, shpirti i Zotriut tonë të Dërguarit të ALLAHUT nuk qe krijuar dhe nuk ka ekzistuar para se t'a lindëte nëna e tij!>>

Meqë shpirti nuk është diçka që depërton në një trup nga jashtë, a thua atëherë pas vdekjes do të mund të hyj në një trup sa e sa herë?

Ndjekim kapitullin vijues...

21



RIINKARNIMI DHE NDËRHYRJA E <<EXHINËVE>>

92

Jam përpjekur t'a shpjegojë kuptimin e emrit <<ALLAH>> dhe <<DIN-in ISLAM>> sa më mirë që kam mundur. Nuk jam një mbrojtës i <<Islamizmit>>!

Të gjitha idetë e paraformuara ose një veprim i tërë që del nga interpretimet e këqija të muslimanëve, përfshirë edhe vetveten time, nuk mund të përvetësohen në<< DININ ISLAM>>

Sipas Sistemit, rendit të Përgjithshëm që e ka krijuar <<ALLAHU>>, do të thotë <<DINI ISLAM>>, çdo individ do t'i heq pasojat e gjendjes tij natyrore dhe cilësive që i shpreh kështu si dhe veprimeve të tija. Në këtë SISTEM, asnjë arsyetim nuk merret paasys. Nuk ka vend për emocione ose ndjenja në funksionimin e këtij SISTEMI.

E kaluara e shkuar nuk zihet më, n'asnjë mënyrë. Mund të shërbehemi vetëm me të tashmen. Në këtë SISTEM nuk ka kthim prapa. Mendimi se do të kthehemi sërish në këtë botë, në një trup tjetër pasi të jemi ndarë nga fiziku ynë me vdekje

dhe kemi kaluar në botën e njohur <<bota e varit>>dhe në atë të<<Berzahut(kalimtare)>>, s'është gjë tjetër veçse një mashtrim. Sepse jeta shkon gjithnjë vetëm përpara, pa asnjë kthim prapa.

Pse nuk është e vlefshme teoria e <<riinkarnimit>>?

Ideja e një shpirti që vjen mbi tokë për të hyrë në një trup tjetër është e pamundshme, sepse siç kam thënë tashmë, shpirti(ruh)nuk është një substancë e krijuar në të kaluarën diku tjetër! Atëherë si mund të kthehet në këtë botë për të hyrë në një trup fizik?

93

Që nga dita e 120-të e shtatëzansisë, truni i çdo qenjeje njerëzore fillon t'a ndërtojë shpirtin e vet. Ja pse është marrëzi të diskutohet mbi një shpirt që do të vendoset në një trup tjetër pasi të jet ndarë më parë nga nga një trup me vdekje.

Teoria, sipas së cilës shpirtrat riinkarnohen në botë nga një periudhë në tjetrën, rrjedhë nga Paganizmi i Turqëve të moçëm, nga varëmhësit turq dhe botëkuptimi tyre dualist mbi një Zot të ndodhur lartë në qiell dhe një populli këtu poshtë(në këtë botë). Ajo mbështetëj mbi një ide të dysisë, të materies dhe shpirtit në jetë, që do thotë të dualizmit si dhe të një mendimi se shpirtrat drejtojnë trupin fizik....

Pas vdekjes, është e pamundur që një qenje njerzore të rikthehet në këtë botë, siç është edhe e pamundur të hyhet në bashkëbisedim me të. Nuk ka të huaj t'ardhur nga gjithësia në formë trupi të ngurtë, ngjashëm me njerëzit, sikur edhe që nuk mund të kihet çfardo bashkëbisedimi me ata. Nuk mund të ket as qenje që futen (hyjnë)në këtë botë dhe komunikojnë me njerëzit duke marr formën e shpirtit të njerëzve të vdekur në të kauarën ose në formë të Shenjtish(wali).

Ne kemi sjellë më shumë hollësi mbi këtë çështje në librin e titulluar <<SHPIRTI-NJERIU EXHINI>> botuar më 1970 si libër referimi.

Duke u paraqitur në forma të ndryshme, këto shfaqje të huaja, nuk janë gjë tjetër veçse<<DJAJË>>, t'ashtuquajtur dhe <<exhinë>>që manifestohen dhe futen tek disa njerëz me emra të ndryshëm dhe pastaj dëshirojnë t'i mbizotrojnë në natyrën e tyre të bashkëlindur. Kur'ani Kerim i shenjon këta exhinë si <<Djaj>> për shkak të veçorive të tyre.

Për t'a bindur një njeri, këta exhinë fillimisht, të njohur si <<Djaj>>paraqiten në forma të ndryshme ose si jashtëtokësorë, të Shenjtë(evlia)ose edhe si Pejgamberë, atëherë arrijnë t'i bindin mijra të pafajshëm, naivë, dhe i ngjiten të parit prej njerëzve që e mashtrojnë.Shmang'ja më e rëndësishme që duan t'a imponojnë exhinët në rrugën e besimit është <<rimishërimi-riinkarnimi>>. Kjo është shqyrtuar qartë në mësimet dhe të dhënat mbi <<exhinët>>.

94

Të gjitha format e profecisë, marrë në përgjithsi u dedikohen ndërmjetësimi të exhinëve. Të dhëna më të plota mund të gjeni në librin tonë të sipërpërmendur.

Ata ndërhyjnë në magji dhe magjistari. Armëmbrojtja më e mirë kundër djajve është, me aq sa dimë ne, dua(lutja) e përmendur në Kur'ani Kerim që ne e kemi testuar sa e sa herë:

"RABBI INNI MESSENIJESH SHEJTANI BINUZBIN VE AZAB...RABBI HEMEZATISH SHEJTANI VE EUZUBIKE RABBI EN JAH DURUN"(Sad:41, Muminun:97-98)

Kushdo prej jush që është i shqetësuar ose tmeruar nga exhinët duhet t'a këndojë këtë lutje. Nëse ju do t'a zbatoni këtë dua, dyqind ose treqind herë në ditë, do të jetë me dobi

të madhe....Do të jetë vetëm për mbrojtjen tuaj, do të jetë e nevojshme të thuhet njëzet ose dyzetë herë çdo mëngjes dhe mbrëmje.

Ndonëse njerëzit që kanë marrëdhënie me <<exhinët >>e ashtuquajtur<<Djaj>> gëzojnë përfitime të përkohshme materiale në këtë botë do të kenë humbje të mëdha në jetën e pasvdekjes për shkak të devijimit tyre nga besimi me <<exhinët>>.

Gabimi më i madh që u shkaktojnë exhinët njerëzve është shtytje e vazhdueshme që t'i nxitë të tjerët.

95 Megjithatë nëse një njeri përdor kohën e vet që të merret me vetveten në vend se t'i mërzis të tjerët, kjo do t'i ishte me shumë përparsi në jetën e pasvdekjes.

Kur'ani na njofton se exhinët t'ashtuquajtur<<DJAJ>> janë <<armiqët tonë. Ju mbetet juve tash të vlerësoni!

Ne do t'ju flasim mbi jetën e pasvdekjes! A thua çfarilloy jete është kjo në të vërtetë?

* * *

22



SI ËSHTË JETA PAS VDEKJES

96

Ne do të përpiqemi të flasim shkurt se si paraqitet jeta pas vdekjes dhe kjo sipas njohjes sonë të fituar nga burimet e mira....

Megjithate, kjo ka të bëjë me bindjet tona vetjake dhe asnjëri nuk obligohet t'i pranojë. Ju mund të përfitonit, nëse janë në pajtim me arsyen tuaj, me logjikën tuaj dhe me njohjen tuaj, ose thjesht ju thoni se ky është një besim tjetër. Kjo temë është trajtuar gjërsisht në hollësi në kapituj të ndryshëm të librave tonë të titulluar :<<UDHËTIMI DREJT HËNËS>>, <<Ç'far KA LEXUAR MUHAMMEDI>>dhe <<ALLAHU I LAJMËRUAR NGA MUHAMMEDI>>.

Trupi i njeriut shndërrohet në energji bioelektrike. Ai punon si një uzinë organike. Kjo energji bioelektrike jo vetëm se e ushqen trurin por edhe i gjallëron qelizat e trupit(fizikut tonë), me ndihmën e një sistemi i ashtuquajtur sistemi neural. Ndryshe, mban lidhjen e shpirtit me trupin me ndihmën e një force magnetike. Energjia bioelektrike që e merr trurin gjason me rrymën elektrike, me të cilën furnizohet ordinatori.

Në fakt truni nuk mund as << të shoh>>e as <<të dëgjojë>>. Ai funksionon si ordinatori dhe krahason valët e hyra të disa frekuencave me disa të dhëna që tashmë ka grumbulluar dhe ne bazë të kësaj nxjerrë përfundime.

Derisa truni e drejton trupin, ai njëkohësisht ndërton(krijon)<<SHPIRTIN>>. Sikur edhe telepatia është njëlloj komunikimi ndërtrunor mbi bazën e valëve, shpirti njeriut është një trup paralel i bërë nga valët me ndihmën e trunit. Ka një ndërveprim të vazhdueshëm (një shkëmbim i energjisë dhe informatave)ndërmjet trunit dhe shpirtit.Truni grumbullon tërë energjinë e prodhuar (brenda tij)si dhe rezultatet e të gjitha veprimeve mendore, në një trup në formë valësh që përbën shpirtin.

97

Vdekja është një shndërrim. Në çastin kur truni pushon së vepruari për

ndonjë arsye, energjia bioelektrike e shpërndar nëpër qeliza nëpër gjithë

trupin me ndihmën e sistemit neural, ndahet dalngadal nga trupi (fiziku

ynë) duke filluar nga gishtat e këmbës e duke u ngjitur lartë...Njëkohësisht

ndahet edhe shpirti dhe lirohet nga trupi(fiziku).

Që nga ky çast, vetëdija mbahet në jetë në <<trupin shpirtëror>>. Vdekja nuk shkakton kurfar ndërprejeje të vetëdijes. Në të shumtën e kohës, njeriu nuk është i vetëdijshëm se ka kërkuar vdekjen. Derisa pranon me vetëdije gjithë çka ndodhë përreth tij, ai papritmas fillon të panikojë për shkak të britmave të njerëzve që e qajnë. Atëherë ai shqetësohet dhe vuan. Ai vështron njerëzit që

merren me larjen e tij si dhe ata që e kryejnë varosjen. Panika më e madhe e pushton trupin e tij kur trupi tij lëshohet në var ; derisa ai ende është i vetëdijshëm dhe i gjallë, fatkeqësisht duhet të varoset bashk me trupin e tij.

Sikur edhe ëndrat tuaja që bëhen nën ndikimin e pashmangshëm të gjërave që ju i kini jetuar gjatë ditës dhe ju nuk mund të ndrroni asgjë, ju pra nuk mund t'a lini as trupin tuaj (fizikun) pas vdekjes, sepse ju jini konsideruar i tillë gjatë tërë jetës suaj.

Kështu, ju do të ndodheni i varosur në një var me të njejtin trup, bile i dëgjoni edhe hapat e njerëzve duke u larguar. Ndonëse ju kini qenë më i pasuri, ose ju kini qenë i rangut më të lartë ose ju kini qenë njeriu më i famshëm i botës, ju atje do të ndodheni vetëm, në një mjedis krejt të huaj!

98

Po si jeta në botën trupore ka anën subjektive dhe objektive, jeta në botën shpirtore paraqet këtë aspekt të dufisht. Trupi shpirtëror ndijnë Ferin (Xhehenemin), djajt që banojnë si dhe njerëzit e Parajsës(Xhennetit)....

Nëse nuk përgatitemi për situata të tilla të jetës së ardhme, sipas udhëzimeve të të Dërguarit t' ALLAHUT, atje(në botën e varit) s'mund të bëhet asgjë përveç se mund të hiqen pasojat e shpërfilljes. Kjo është quajtur <<dënimi varit> dhe mënyrën e jetës që do ta durojmë atje.

<<Wa l-baa'thu al-mawt>> në <<Amentu>> do të thotë << vazhdoni të jetoni në një trup tjetër menjëher pas vdekjes>>dhe jo kthim në jetë DITËN E GJYKIMIT FUNDIT, pas vdekjes. Për më shumë hollësi shifni kapitullin <<Besimi në jetën e përtejme(asobotshme)>> në librin tonë të titulluar <<REZONIMI DHE BESIMI>>.

Një jetë e tillë zgjatë deri në DITËN E GJYKIMIT FUNDIT. Në botën e quajtur <<Berzah>>, ndërmjet dy botëve, disa jetojnë sikur të jenë në ëndër në shtretërit e tyre. Pejgamberët, Shehidët dhe një pjesë e Evlijave janë të lirë në veprimet e tyre.

<<Trupat shpirtëror >>marrin një ndërtim të ri pas DITËS SË GJYKIMIT FUNDIT sipas kushteve të këtij mjedisi dhe do të jetë një <<bath >>i ri. Do të përpiqen t'i shpëtojnë Xhehenemit. Ata që e kalojnë Xhehenemin do të përjetojnë një <<bath >>të ri dhe shndërrohen në trup të shkëlqyer(nga drita) në vend të trupit shpirtëror. Këto qenje, tash e tutje qojnë jetën e tyre në përmasën e quajtur Xhennet në cilësinë e qenjeve të shkëlqyera <<munawwer-dritë>>(mendohet ne dritn hyjnore). Kjo, ALLAHU e di më së miri(Al ËSHTË MË I DISHMI), do të zgjas me miliarda vjetë!

* * *

23



NE E KEMI SHNDËRRUAR <<RAHMETIN >> NË NJË ORTEK!

100

<<Dini –ISLAM >> është <<rahmeti>>(mëshira) më i madh(e) që do të na vie porsì shiu dhe bora...

Nga ana tjetër, botëkuptimi <<Islamizmit>>është si një orteK i formuar nga një shumësi komentimesh. Ajo shkel çdo njeri që has në rrugën e saj. Për ata nuk mjaftojnë fjalët për të përshkruar se si <<DINI ISLAM>> është bërë aq i vështirsuar, deri n'at masë, aq sa sot vështirë mund të kuptohet.

Përkundër udhëzimeve të Resul-ALLAHUT sa i përket Din-it ISLAM :<<Bëni ate të lehtë, jo të vështirë, kurajoni njerëzit t'a duan ate jo t'a urejnë >>, gjithçka është vënë në veprim për t'i shmangur njerëzit nga <<Din-i Islam >>. Bile mund të thuhet se pengesa më e madhe ndërmjet <<Din-it Islam>>, janë vetë muslimanët.

Pa llogaritur fare se u deshtën plotë njëzet e tre vjetë që Kur'ani Kerim të shpallet i plotë. Janë të shumtë ata që iu shmangën Din-it Islam për shkaqet e sipërpërmendura. Kjo i ngjanë një të posalinduri që duan t'a ushqejnë me mish

<<lope >>, duke pohuar se është shumë i dobishëm. Shumë madh njerëz të tmeruar nga një sërë ligjeratash (hytbesh) të dëgjua nepër xhami janë nxitur të ikin.

Secili kënaq egon e vet pasi t'i ket cilësuar të tjerët <<qafira >> kur të këta të fundit e shpjegojnë <<Din-in Islam >>ndryshe. Përpiqen bile edhe t'i vrasin duke pohuar <<se është vaxhib(detyrë) të vrasish!>>. Megjithatë urdhëri i të Dërguarit t'ALLAHUT lidhur me këtë është e qartë :

<<Nëse dikush dikend e cilëson si <<qafir>>dhe ky i fundit është një besimtar, ky i pari bëhet vet <<qafir>>!

101

Përkundër kësaj, muslimanët e Afganistanit dhe në shumë rajone të tjera nuk pushojnë të vriten në mes vedi, duke cilësuar njeri tjetrin për <<qafir>>!

I dërguari i ALLAHUT lidhur me këte paralajmëron edhe :<<Vrasësi sikur edhe i vrari që mprehin shpatat me qëllim që të vriten në mes vedi shkojnë të dy në XHEHENEM!>>.

Ndryshe ka edhe shumë njerëz që i cilësojnë njerëzit si <<qafir>>, thjeshtë vetëm se nuk mbajnë mbulesën.

Dredhiçka më e madhe e disa njerëzve për motive ekonomike-politike, është që t'i cilësojnë të tjerët <<qufarë>> vetëm nëse nuk i përkrahin të sipërpërmendurit.

Sipas <<Din-it Islam>> dhe të Dërguarit t'ALLAHUT, të gjithë njerëzit që e deklarojnë vetëdijshtëm(me bindje)formulën e dëshmisë<<La ilahe lla –ALLAH>>, do të thotë duke e pohuar atë në kuptimin e saj të mirëfillt, do të hyjnë në Xhenet....

“Që të gjithë, pa përjashtim, do t'a kalojnë ambientin e XHEHENEMIT, pastaj secili do të shpërblehet për veprat e veta. Disa do t'i shpëtojnë këtij XHEHENEMI dhe do të

vendosen në Xhennet...>> Kështu është shpjeguar kjo në Kur'ani-Kerim dhe në mënyrë më të hollësishme.

Prandaj, nuk është e arsyeshme të sulmohet kushdoqoftë se do të shkojë në Xhehenem, pse bëri ose nuk bëri kështu! Në të vërtetë <<Xhehenemi është është shtegtim i të gjithëve dhe i secilit>>. Me një rëndësi të veçantë është të mund të kalohet me sa më pak të keq, në saje të praktikave (ibadeteve) të kryera.

Ndonëse individi nuk i kryen tërë e praktikat e këshilluara me <<Din-in Islam>>, n'asnjë mënyrë kjo nuk e përjashton individin nga feja përkatëse dhe ne nuk kemi të drejtë t'a trajtojmë si <<qufar>>, e as t'a urejmë. Përkundrazi, ne duhet t'a dallojmë aktorin e vërtetë (Fâili Hakiki), ndryshe mund t'a mbulojmë pamjen tonë dhe kështu do t'a rrezikojmë besimin tonë.

102

<<Din-i Islam>> u drejtohet shpirtit dhe mendjes; të sëmurit mendor nuk janë përgjegjës për veprimet e veta. Sepse besimi dhe bindja e njerëzve duhet të mbështetet në vet veprat e tyre dhe të kuptuarit e tyre.

Është një gabim i madh të shtyhen njerëzit vetëm në mbamendje përmendsh ose imitim, duke përkratur (bindjen) se <<Din-i Islam>> është njëllë tregimi (rrëfimi) mbi fenë. Mendoj se këta mbrojtës fanatikë nuk janë të vetëdijshëm mbi përgjegjësinë e tyre para ALLAHUT, meqë tërheqin pas vete masën dhe pohojnë se <<ata nuk kuptojnë asgjë., prandaj ju mjafton imitimi>>, harojnë se njerëzit janë krijesat më të nderuara >> (Ashrafu al Makhulat).

Sipas Traditës së të Dërguarit të ALLAHUT :

Parimet themelore të besimit janë besimi në <<ALLAHUN >> dhe në <<AHIRET>>, që të thotë në jetën e përgjithmonë të pasvdekjes! Kjo nënkupton dy parimet tjera themelore :

1. Mos adhuroni një Zot të përfytyruar, largë jush, dhe i veçuar prej jush, por kuptoni <<ALLAHUN >> dhe gjejeni <<ATË>> në vet qenësinë tuaj, më mirë se sa t'a kërkonti diku jashtë, dhe drejtoni jetën tuaj mbi bazat e cilësive të <<TIJ>> që ju i bartni në vetveten tuaj, dhe në jetësimin e tyre...

2. Nëse ju nuk mund t'a kuptoni njëmendësin e jetës së pasvdekjes, e quajtur <<Ahiret>>, ju të paktën besoni në këtë!

Përveç dy kushteve të sipërpërmendura, ju duhet të besoni Engjujt, Librin dhe të Dërguarin e ALLAHUT, që të keni ju vet vet burimin tuaj t'informatave dhe t'i zbatoni praktikat (ibadetet) e urdhëruara në mënyrë që t'i mblidhni frutet në jetën tuaj të mëpastajme. Shihni librin tonë të titulluar <<MENDJA DHE BESIMI>>.

Këtu shtrohet një pyetje shumë e rëndësishme : Këshillat që u drejtohen njerëzve në Kur'an, a mos janë një pako kompakte....Që do të thotë secili mund t'i ndjekë këto këshilla brenda mundësive dhe së këndejmi do të shpërblehet për atë që ka punuar dhe do t'i heq pasojat për atë që ka shpërfillur!

Ne nuk kemi kurfar të drejte t'i gjykojmë të tjerët. Gjykimi i përket ALLAHUT!

Duhet të dijmë se gjëja më kryesore që na duhet është njohja e <<ALLAHUT>> dhe e <<Din-it Islam>>. Gjëja e parë që duhet t'a bëjnë muslimanët është se nuk duhet t'i kushtohen konstruktive dhe kotësirave të kësaj bote por për më tepër t'i kushtohen në një qëllim të vetëm në përhapjen e

shkencës(ilm) së Fesë tek të gjithë njerëzit. Sepse shpërfillja e aq praktikave të vlefshme nga njerëzit për shkak të mosdijes së tyre, sigurisht se do të qojë kah një shkatërim i madh, prej të cilit do të vuajnë të gjithë!!!

Tash shënova <<shpërfillja e praktikave nga ana e njerëzve>>, kjo do t’jua kujtojë disave çështjen e mbajtjes së <<mbulesës>>. Ne do t’a shtjellojmë këtë temë në kapitullin tonë t’ardhshëm.

* * *

24



ÇËSHITJA E MBULESËS

<<Islamizmi >>, a simbolizon mbulesën?

106

Gjithnjë i njeiti problem ngritet sot kur të diskutohet mbi <<Islamizmin>>në një numër vendesh sikur s'ka se çka të diskutohet. Në fakt kjo ka të bëjë me mbulesen(shamin)! Disa sish, femrat që nuk mbajnë mbulesë i konsiderojnë si jomuslimane, ndërkaq barbarët tjerë nuk i trajtojnë si qenje njerëzore femrat që mbajnë mbulesë dhe orvaten bile t'ua marrin këtë të drejtë.

Sipas disave mosmbajtja e mbulesës është krim kundër njerëzimit, për të tjerët, duhet mbajtur mbulesen.

Mbajtja e mbulesës është një urdhër për gratë muslimane që nga viti 17-të, nga 23 vjetë të zbritjes së Kur'anit. Janë të shumta ajetet kuranore që shënojnë nevojshmërinë e mbajtjes së mbuleses. Është një domosdosi fetare që ato të mbulohen. Pa dyshim se është e dobishme për femrat që ato të mund t'a respektojnë këtë kërkesë....

Poashtu, ne duhet t'a nderojmë një motër që mban shamin, nëse për asgjë atëherë nga mirësjellja, që ta nderojmë

besimin e saj fetar. Është e pamundur të mos respektohet kjo motër që mban një jokomoditet për shkak të besimit saj. Megjithatë, në mes nesh ka barbarë që i gjykojnë femrat të cilat mbajnë një mbulesë të tillë të hijshme si shenjë nderimi të besimit tyre fetar. I urrejnë ato dhe ua rrëmbejnë nga dora të drejtën e tyre qytetare dhe të drejtën e jetesës.

Megjithatë këta të molepsur (të ligë) janë të shumtë në mes nesh. Luftojnë të drejtën e këtyre besimtareve në shkollimin universitar dhe ua ndalojnë t'i ushtrojnë lirshëm profesionin e kirurgut, juristes dhe të profesoreshës.

Këto reagime shkojnë në dobi të politikanëve dhe partive të tyre si një arsyetim për t'a mbrojtur besimin fetar të njerëzve dhe kështu gjejnë mënyrën për t'a politizuar fenë.

Të luftohet mbulesa do të thotë të luftohen të drejtat e njeriut dhe të qytetrimin. Njëherit kjo është të luftosh të drejtën e njerëzve në pajtim me besimin e tyre pa i shqetësuar të tjerët. Në fakt një sjellje e tillë nuk falet vetëm nëse kjo vjen nga një i sëmure mendor!

Ndërkaq sa i përket atyre që i konsiderojnë femrat besimtare jomuslimane pse nuk mbajnë shami, bile i quajnë edhe <<qafire>>, reagimi tyre, s'mund të cilësohet ndryshe vetëm si padije.

Kur'ani dhe Pejgamberi Muhammed në këshillimet e tyre porosisin njerëzit të mos e adhurojnë një çfardo Zoti dhe të përgaditen për jetën e pasvdekjes!

Secili bën atë që di më së miri dhe do të bartë kështu pasojat për vetveprimet e tij.

Sipas Traditës të të Dërguarit të ALLAHUT në Sahihul BUHARI, dëshmia e <<La ilahe ILLA ALLAH>>, për një njeri të

arsyeshëm është një shprehje (shenjë) e besimit (iman). E nëse dikush e cilëson një besimtar si <<qafir>>, akuzuesi bëhet vet <<qafir-i pafe>> (ky që fsheh, shtiret sikur nuk e njef të Vërteten e vet)! Pra si përfundim këtu nga ajo që u tha më sipër, fakti të trajtohet një besimtare <<qafire>> se nuk mban mbulesë e bën vet akuzuesin <<qafir>>!

Nëse do t'i numrojmë urdhëresat e ISLAMIT me rradhë sipas rëndësisë së tyre, praktikat që qëndrojnë në krye janë : Namazi, agjërimi, Haxhi, Zeqati.

Pastaj vijnë urdhëresa të tjera si : ndalimi gjakderdhjes(vrasjes), thashethemet, përfolja e tjetrit, që është sikur t'ia hash mishin vllait tënd të vdekur >>. Të shtojmë më pastaj pas gjithë këtyre urdhëresave, tek tash vjen mbajtja e mbulesës.

108

Një muslimane ndjek këtë urdhëresë të Kur'anit sipas mundësisë. Megjithatë nuk është e njerëzishme që një muslim t'a quaj jomuslimane një motër pse nuk mban mbulesë, ose t'a cilësoj si hipokrite ose edhe më t'a cilësoj si <<qafire>>.

Fakti se kjo femër nuk mban mbulesë, nuk e pengon t'i zbatojë praktikat tjera si Namazi, agjërimi, aq sa të mundet ajo. Ajo bile mund të shkojë edhe në haxh, edhe pse pas kthimit të saj, nuk mban edhe më tej mbulesë. Dhe nuk i takon asnjëri t'a gjykojë ate për vet veprimet e saja. Të cilësuarit jomuslimane të të gjitha femrave të pambuluara, nuk ka kurfar kuptimi, nuk janë gjë tjetër vetëm fjalë boshe.

Për një femër e cila njeh dispozitën Kur'anore mbi mbulesën, por nuk e bartë për shkak të jokomoditetit saj dhe kërkon falje nga ALLAHU por zbaton praktikat dhe ibadetet tjera, shpresoj se ALLAHU ia hap dyert e Mirsisë së TIJ.

Përveç tjerash, ne kemi ardhë në këtë botë jo për t'i akuzuar gjykuar njerëzit, por për t'a njohur <<ALLAHUN>>, duke qenë<< AI>> vet njëmendësia(realiteti ynë) jonë dhe që ne të përgatitemi për jetën e pas-vdekjes duke iu përgjigjur kërkesave të nënshtrimit tonë.(urdhërave t'ALLAHUT dhe këshillave të Pejgamberit tonë).

Mos t'a harojmë këte....

* * *

25



CILI ËSHTË QËLLIMI JUAJ

110

Njerëzit që nuk kanë takuar dikend si mua këto kohët e fundit më pyesin :

<<Cili është qëllimi juaj? Ç'far prisni? Ç'far doni të bëni? >>

Asnjë nga veprat e mija të botuara ose të shpërndara nepër disa vende kudoqoft dhe në çfardo forme, nuk ishin nën mbrojtjen e së drejtës të autorit. Asnjera nuk është shkruar me qëllim përfitimi. Këto vepra i janë ofruar falas që të gjithëve përgjithsisht. Secili është i lirë t'i riprodhojë ose t'i përkthejë në gjuhë të tjera dhe në sa kopje të dëshirojë dhe mund t'ua ofrojë njerëzve, me kusht që të ruhet përmbajtja. Nuk kërkoj kurfar kundërshtëpërblymje për veprat e mija. Nuk do të lë kurfar trashigimie pas meje.

Nuk kam as shoqata që të ngarkohem për mbledhjen e kontributeve, as fonde si dhe kurfar qendre të ngjashme. Të gjithë ata që çmojnë veprat tona dhe duan t'i kenë ato u them:

Riprodhoni ato, përhapni dhe shpërndani në mënyrën më të përshtatshme për ju!

Nuk jam anëtar i ndonjë shoqërie, as ndonjë shoqate, as fondi, as klubi ose kongregacioni ; i përkas thjesht Kuvendit të gazetarve të Turqisë, meqë jam gazetar në pension.

Nuk mvarem prej askujt as brenda e as jasht vendit tim. Nuk ju thëras! Përkundrazi ju them :<< mos më ndiqni pas! Nëse ju i bëni shërbim shkencës sonë, kini parasysh sidomos, me ndershmri të plotë, të Dërguarin e ALLAHUT, dhe kjo do të jetë një e mirë!

Do të reagoja si i Dërguari i ALLAHUT me ç'rast u është përgjigjur njerëzve të fisit, kur kanë dashur t'ia ofrojnë mbreterinë Kurejshite, vetëm e vetëm që të heq dorë nga detyra e tij :

111

<< Edhe sikur ju do të ma vejshit diellin në njerën dorë dhe hënën në tjetrën, unë nuk heq dorë nga thirja (rruga ime)!>>

Siq kam theksuar tashmë Feja Islame ka ardhë për t'ua kumtuar njerëzve SISTEMIN e përgjithshëm, Rendin e ALLAHUT. Ai që e kupton këtë Sistem do të vetëdijsohej dhe do t'a përgadiste si duhet jetën e vet të ardhme, që do të thotë jetën e përgjithmonshme të pasvdekjes. Sepse është e pamundur që qenjet njerëzore t'a ndërtojnë jetën e pasvdekjes, përveç duke i kryer detyrat e urdhëruara(këshilluara) gjatë jetës së kësobotshme. Kjo është lehtësuar me SISTEMIN dhe urdhërin e ALLAHUT.

Ja përse, shkenca duke qenë në shërbim të njerëzve që t'a fitojnë përjetësinë është dhurata më e mirë që mund t'u ofrohet atyre!

Ai që është i vetëdijshëm mbi <<ALLAHUN>> është në paqe me tërë botën! Ai nuk mashtron asnjëri.

Ai që ka vetëdije mbi <<ALLAHUN>> nuk pret asgjë nga njerëzit sepse i mjafton <<ALLAHU >>.

Ky njeri porosit të tjerët t'a kërkojnë të Vërtetën dhe përfundon jetën e kësaj botë në qetësinë më të madhe.

Është i vetëdijshëm se të gjithë njerëzit janë robë t'ALLAHUT dhe se duhet t'a drejtojnë jetën e tyre kah qëllimi për çka edhe qenë krijuar. Ai e din se secili do të ndahet nga përmasa(lexo bota materiale) dhe do t'a gjejë vendin e vet në një përmasë tjetër pas vdekjes, qoft ky një i rangut të lartë (Agë ose Pasha), një zotri, një gjeneral, njeri i pushtetit ose një i Shenjt (Weli). Secili prej nesh gjithsesi do t'i heq pasojat e vet veprimeve të veta në përpjestim me përgatitjen për një jetë të këtillë, gjatë jetës së tij të kësobotshme.

112

Ja pse na është e nevojshme t'i njohim kushtet e jetës së përtejme.

Qofshim të lumtur ose fatkeq, heret ose vonë këto ditë të kufizuara(caktuara)përfundojnë dhe s'ka rëndësi se si. Mirëpo ditët e pambaruara(të përjetshme).....?

Ja për këtë arsye ne kemi vlerësuar se ishte detyrë jona t'a ndajmë këtë njëmendësi me të gjithë, largë çdo ndikimi, çdo paragjykimi dhe çfardo kushtëzimi. Njohësit e së Vërtetës do të dijnë sigurisht çdo gjë mbi ne. Ata do të dijnë kush jemi ne dhe çfar bëjmë ne! Megjithate nuk është me rëndësi se çfar dijnë për ne, mosnjohësit e së Vërtetës, njerëzit e botës së jashtme.

Sepse ne nuk presim diç prej dikuj. Kjo është vetëm e vetëm me qëllim që t'a ndajmë këtë dituri(shkencë) për t'jua përcjellur njerëzve.

Nuk është asesi punë e jona që t'i detyrojmë njerëzit të zbatojnë ate që ne e kemi kuptuar, duke qenë se vet Resul-ALLAHU nuk ka qenë i autorizuar t'i detyrojë njerëzit t'a ndjekin!.....

Ja pse ne përndryshe nuk n'a intereson mënyra e jetesës së njerëzve ose edhe parapëlqimet e tyre, ashtu sikur që as atyre nuk do të duhej tu interesonte mënyra e jetës sonë dhe zgjedhja jonë!

Ne nuk jemi për t'u marr si shembull, por është i Dërguari i ALLAHUT.

113

Ne nuk jemi tjetër vetëm se një rob i përlulur në posedimin e kësaj diturie-shkencore që ne e kumtojmë me gabimet e saja, me boshllëqet dhe me te metat e saj.

Miq të mi! Kapni (zëni) diturinë shkencore dhe hiqni prej nesh!

Veproni sipas dijes suaj, në kufinjtë e kuptueshmërisë suaj dhe gëzohuni për kundërshtpërblimin! Djeni se nuk ka falje në jetën e ardhme. Asgjë nuk mund t'a arsyetojë shpërfilljen tuaj. Secili do t'i heq pasojat e veprimeve të veta.

Kini kujdes të mos futeni në gabimet e botës së Antikristit (Dexhallit)! Gjërat e përkohshme të kësaj bote duken të përhershme, njëlloj si gamimet që duken të drejta (me vend)! Kotësitë e kësaj bote duken sikur kanë një vlerë të madhe. Ata që janë nën mvarsinë e exhinëve krijojnë përshtypje të jenë Hoxhallarë, Zotrinjë, Dijetarë (Ylema) ose edhe Sheik Predikojnë vazhdimisht të ndaluarat dhe nuk gjykojnë!

ALLAHU na ruajt nga dashja e ndonjerit prej tyre dhe na i lehtësoftë punët që të mund të përgatitemi për jetën e mëpastajme – ardhëmërin tonë, sa më mirë që të jetë e

mundur! Kurfar pendimi nuk do të na bën dobi atje, nëse nuk e kemi zënë dijen e duhur t' ALLAHUT(ilm) dhe nëse nuk i kemi respektuar maksimalisht obligimet tona (fetare)!

Thuajeni këtë lutje:<<ALLAHU im, zbulomi njëmendësitë e Fytyrës sate

dhe më bë t'i kuptojë në mënyrë që t'a qojë jetën nën mbrojtjen e tyre!>>

nesër me emër t'ALLAHUT!

* * *

26



A JEMI NE TË VETËDIJSHËM PËR KËTO FAKTE?

116

Me aq sa dijmë ne.....

Një njeri kishte fituar loto, por duke kthyer në shtëpi, ia kishin vjedhur atë që kishte fituar! Në situata të ngjashme themi :<<Ajo q fitohet pa punë (pa mund) ashtu edhe shkon).Një fjalë e urtë turke lidhur me këtë thotë :” Atë që e sjellë flauta e merr daullja!>>.Të gjithë e dijmë se fitimi më i mirë është ai që fitohet me djersën e ballit...

Ata që e kanë kuptuar <<Fenë Islame >>, fjalët e sipërshnuara i kanë shpjeguar kështu:

<< Gjithçka vjen nga HAJUU i kthehet HU-s!>>.Që do të thotë se çdo gjë që vjen nga <<ALLAHU>>, i shenjuar poashtu me fjalën <<Haju>> (I GJALLI), i kthehet ATIJ, që nënkupton se <<Gjithçka vjen prej TIJ dhe kthehet tek AI!>>. Mirëpo deri më tash njerëzit i kanë dhënë një shpjegim letrar!...>>

Shihni se si është shtrembëruar kjo fjalë në ditët tona dhe ka devijuar nga kuptimi saj burimor! Po kështu ndodhë edhe me

dallimin që ekziston ndërmjet <<Islamizmit >>dhe <<Din-it Islam>>.

Të shofim tash disa fakte të tjera që ne besojmë se i dijmë!

Pse ne marrim abdest? Ju do të më përgjigjeni :<<Që të pastrohemi!>>.

Nëse <<abdesti >>n'a është këshilluar me qëllim të pastrimit, përse atëherë n'a është urdhëruar<<tejemmyi>> që ka të bëjë me fërkimin e fytyrës dhe duarve me dhé, në mungesë të ujit?

Ju do t'i thuani dikujt :<<Vlla i dashtun! fytyra jote ka nevojë të pastrohet, por nuk ka ujë, shko pastroje me dhé>>.

117

Shumica prej nesh jemi familiarizuar me faktin se qelizat mbi sipërfaqen e lëkures, thithin ujin me të cilin fërkohemi, me ndihmën e osmozës....Poashtu e dijmë se uji që përfaqësohet me formulën H₂O, (i përbër nga atomet e hidrogjenit dhe oksigjenit), ka po kështu edhe një ngarkesë_elektrike. Na është e njohur edhe se uzina organike, që është trupi ynë,(fiziku) shpërbën lëngjet dhe ushqimet që i merr dhe i shndërron në energji bioelektrike.

Megjithatë ne fare nuk kemi menduar se <<abdesi>> na paska qenë urdhëruar për t'a rritur energjinë bioelektrike.....

Po ç'thuhet atëherë për tejemmymin! Ne jemi përpjekur t'a shpjegojmë këtë në librin tonë titulluar <<Misteret e Njeriut>>. Shpresoj se ia kemi arritur kësaj me sukses, dhe pa dyshim, sipas aftësive tona....

Mendoni ju se a thua mund të bëhet fjalë për një pastrim, si marrja e abdestit me një gotë ujë ose tejemmy me pak dhé?

Meqë abdesi nuk është bërë si qëllim pastrimi.....Meqë i Dërguari i ALLAHUT ka marr aq shumë abdes vetëm me një gotë ujë.....atëherë ne si do t'a konsiderojmë abdesin dhe t'a kuptojmë rregullën sipas së cilës <<ata që nuk janë pastruar <<tahir>>nuk duhet t'a prekin Kur'anin?

E kundërta e <<tahir>>(pastrim)në Kur'an është fjala <<nexhis>>(i papastër).Termi <<nexhis>> i shoqërohet ides <<shirk>>(politeizëm) dhe është përfunduar se <<mushrikët>>(politeistat) janë naxhis. Kjo do të thotë, se <<shirku>> është <<nexhis>>, pra të qenit <<tahir>>lidhet me gjendjen e njerëzve të <<TEHVIDIT>>, NJËSISË. Me këtë rast paralajmërimi i Kur'anit :<<ata që nuk janë pastruar (ghayr-mutahharûn)nuk duhet t'a prekin Kur'anin, nuk do të thotë se nuk duhet prekur ose mbajtur kopjet e Librit të Shenjt, pa abdes...>> Kjo do të thotë më shumë, ata që nuk janë pastruar nga gjendja e <<shirkut>>dhe nuk e kanë arritur <<TEWIDIN>>nuk duhet të lodhen t'a kuptojnë Kur'anin sepse ata nuk arrijnë as që të futen në kuptimin e mirëfillt. Nuk është fjala për një papastërti fizike që duhet të hiqet(pastrohet) por më tepër një ndyrësi mendore në shpirt!

118

Është fare e pamundur të kuptohet misteri i Kur'ani-Kerimit në një pikpamje <<dualiste >>, që do të thotë duke u nisur nga ideja e një <<UNI (vetjak)dhe një Zoti diku, largë!>>

Një pikpamje e tillë shpie në t'ashtuquajturën <<shirk al-khafi>> (politeizëm i fshehur, për të cilin nuk jemi të vetëdijshëm)! Pik së pari kemi nevojë t'a kuptojmë <<Tewidin>> Dhe vetëm atëherë bëhemi <<mutahhar>> dhe fillojmë t'a kuptojmë Kur'anin.

Derisa nuk jemi <<mutahhar>> dhe nuk ia dalim të shkarkohemi prej shirkut mendor, të rrënjosur në shpirtin tonë, që do të thotë <<nexhasa>> nuk do të mund t'a

kuptojmë Kur'anin në vlerën e tij të njëmendtë. Kështu, këta njerëz e konsiderojnë Kur'anin si një libër urdhërash të një zoti, ndodhur diku, dhe përcjellur nepërmjet një lajmëtari. Sidoqoftë, kurrë nuk do të mund të pastroheshim<<mendësisht >> edhe sikur tërë ditën të laheshim!... As nuk do të mund të binim në sexhde!

Ju do të më pyetshit, vërtetë mendoni për <<sexhden>>.

Sigurisht që po! Pasi ai që nuk është pastruar (mutahar), nuk mund t'a kryej sexhden!

119

Paramendoni sikur <<sexhdeja>> është përshkruar si një shprehje nderimi një Zoti të padukshëm dhe që krahasohet me përuljen një Sulltani?...Një sjellje e tillë s'është gjë tjetër pos një <<politeizëm i fshehur >>(shirk al -khafi) dhe u përket vetëm atyre që nuk janë pastruar ende << me mend>>!

A e kryeni ju <<sexhden >> për një Zot të ndodhur diku? Ose në kuadër të shërbesës suaj, duke lënë që të shfaqen atributet e <<ALLAHUT>> që janë në vet ju, kur ju jeni të vetëdijshëm për praninë e <<ALLAHUT>> në çdo çast, në çdo vend, në çdo gjurmë të qenësisë suaj....

A e kryenit ju <<sexhden >> për të zbuluar kuptimet e Emrave më të bukur t'ALLAHUT, që formojnë ekzistencën tuaj, duke përfutur nga qarkullimi plotësues të gjakut të derdhur, që ushqen trurin tuaj pak nga pak derisa ju t'a kryeni namazin, gjatë përsiatjes dhe lutjes (në pozitën e sexhdes)? A mendoni ju se një ide e tillë e më poshtë përmendur është mënyra më e mirë e përshkrimit të sexhdes?

<< Sexhdja ime dhe mosvedija ime! Nuk ka tjetër pos TEJE që është mbështjellë në një trup nga mishi e gjaku dhe se TI je zbuluar nepërmjet fjalës UNË>>, derisa truni bëhet më i

fuqishëm me rrjedhjen e gjakut që e merr në pozitën e sexhdes dhe i përcjellë valët mendore edhe më të fuqishme në SISTEM >>.

Ose ne do të njifemi shumë mirë dhe sendërtojmë vet forcat tona, fuqinë tonë, ose ne do të udhhiqemi(drejtohem) prej atyre që na qeverisin!.....

* * *



KËNAQËSIA E EGOS ME NDIHMËN E DOMINIMIT

122

Në krahasim me shkallën e fuqishmërisë së emrit <<RABB>>, duke qenë ndër emrat më të bukur t' ALLAHUT, duke ndërhyr në strukturën tonë, ne kemi veti që anojnë kah <<qeverisja dhe dominimi i të tjerëve>>. Dhe në rrethana të veçanta kjo fjalë manifestohet në përpjestim me mjetet që i zotërojmë!

Disa njerëz përpiqen t'a kënaqin këtë koftje me ndihmën e të hollave! Këta individë i vëjnë njerëzish nën sundimin e tyre, në saje të fondeve të tyre dhe kënaqen t'i qeverisin. Pa dyshim, nuk janë vetëm ata që i duan të hollat që mund të jenë të qeverisur prej tyre.

Të tjerët sundojnë njerëzit në saje të titujve dhe mjeteve që i mbajnë ata, duke i detyruar të jetojnë sipas qejfit tyre. Kështu e ndjejnë kënaqësin këta individë. Ata kanë një pozitë epërsie dhe e shfrytëzojnë këtë për t'i shtypur njerëzit!

N'anën tjetër, një kategori tjetër individësh e përdorin fenë si mjet për t'i qeverisur njerëzit. I kërcënojnë ata që nuk i nënshtrohen autoritetit tyre duke u thënë : <<Ju do të

hidheni në Fer >>, gjithnjë duke ua premtuar Parajsën, atyre që duan t'i ndjekin (tu shkojnë pas larove).....

Ndoshta edhe nuk i përdorin ato të holla të grumbulluara për nevojat e tyre individuale, por sapo t'a mbledhin një shumë të madhe, i blejnë njerëzit dhe arrijnë <<pozitat>> e tyre, në saje të asaj që do të jetësojnë me këto të holla, duke u sjellur kjo një kënaqësi të madhe! Botëkuptimi materialist i religjionit rrjedhë poashtu nga dëshira e pangopur për të qeverisur dhe për të sunduar. Këto janë veçori që u përkasin Zotrinjëve(bujarë-Rubûbiyet). Këta njerëz konsiderohen si çoban, ndërsa të tjerët në syt e tyre janë si kopë dhensh!.....

123

Poashtu është një kategori tjetër njerëzish që e përdorin fenë si armë duke u mbështetur në strukturat politike. Ata thonë se i Dërguari i ALLAHUT ka ardhë për t'a vendosur një mbretëri fetare. Pohojnë se njerëzit që u binden shkojnë në Parajs, ndërsa ata që nuk pajtohen do të hidhen në Fer, si jobesimtarë (qufar), duke rahatuar kështu pushtetsin e tyre.

Ishte një njeri në kohën e Pejgamberit Isa(Jesu)alejhiselam, i quajtur <<Barabbas >>. Ai drejtonte një qeveri të veçant për joçifutët dhe i bashkonte këta të fundit kundër çifutve. Shpesh kishte mbështetjen e Isa a.s. dhe bënte përpjekje të mëdha për t'a rahatuar liderin e tij politik e fetar dhe të sjellë një fitore kundër çifutve. Pejgamberi Isa alejhiselam ju përgjigj kështu :

<<Ftoj njerëzit që të punojnë në tokë për t'a fituar Mbretërin e Parajsës (Xhennetin) e jo Mbretërin e tokës, me vendosjen e një pushteti-qeverie>>.

Ai donte të thoshte se duke u marr me këto çështje në këto ditë të afatizuara që ne po i jetojmë, njerëzit harojnë të përgatiten në jetën e pasvdekjes (ahiret)dhe t'i kryejnë punët

e dobishme për t'a fituar Xhennetin, që ALLAHU ua ruajti atyre....Dhuratat e përjetshme të<<Ahiretit>>janë më të dobishme se sa një Mbrettri(Sulltanat) i kësaj bote.....

I Dërguari i ALLAHUT, Muhammed Mustafa ka refuzuar Mbetërin e fisit KUREJSHIT që ia ofruan, sikur edhe të gjitha epërsitë tjera duke ju përgjigjur :

...<<edhe sikur të ma vendoshin diellin në një dorë dhe hanën në tjetrën unë nuk heq dorë nga rruga ime(thirja n'islam>>...., sepse më e rëndësishme për te ishte që njerëzit të mësojnë për t'a kuptuar SISTEMIN dhe t'a zbatojnë ate në praktikat e tyre(ibadetet) që janë përgatitje për jetën tjetër të përgjithmonë se sa epërsitë e një jete të përkohshme.

124

Po, do të ketë gjithmon njerëz që e dëshirojnë me afsh pushtetin dhe sundimin.

Dhe do të ketë gjithmonë njerëz që duan aq shumë të jenë të sunduar dhe të qeverisur (të udhhequr).

Dhe krahas gjithë kësaj, do të ketë gjithmon njerëz liridashës që i çlirojnë të tjerët nga injoranca duke ndarë dijen e vet me ata. Këta njerëz të Dijes e dijnë vendin e tyre dhe tërhiqen në vetvete, të rrëmbyer tërsisht me jetën e ardhme.....

Dëshiroj që nën mbrojtjen e të Drejtave të njeriut, të gjithë muslimët e botës që besojnë në <<Din-in Islam>>, t'a çmojnë ate aq sa e kuptojnë, të mund t'a jetojnë këtë fe pa ju shtruar çfardo forme të despotizmit ose dhunës.

Sërish dëshiroj që muslimët të mund t'a kuptojnë si duhet <<Fenë Islame>>, e tillë siç u bë e njohur në formën e saj burimore. Shpresoj se me një të kuptuar të njëmendtë, do t'i ikin shtypjes së tjerëve për t'i bindur në besimin e tyre dhe do të përpiqen për më tepër t'i vetëdijsojnë njerëzit për

njëmendësin, me një çasje paqësore dhe me një afrim paqësor.

Sikur i Dërguari i ALLAHUT t'ishte i pranishëm sot në mes nesh, do të interesohej për ndijësimin e njerëzve, mbi dëmin që do të pësojnë në jetën e përtejme për shkak të shpërfilljes së praktive. Do t'i merrte nën mbrojtje kundër rrezikut që kanoset si tash këtu, në jetën e kësobotshme poashtu edhe në jetën e mëtejme, për shkak se nuk e kanë kuptuar <<ALLAHUN >>në vet qenësinë e tyre. Nuk do të interesohej për vendosjen e një mbretërie fetare ose çfardo mvehtësie...

Pa fije dyshimi, kjo është pikpamja jonë në pajtim me të kuptuarit e dhënë nga <<ALLAHU>>. Nuk mund t'a dij se si është për ju. Na bëft <<ALLAHU>> prej atyre që t'i kuptojmë të tëra njëmendësitë dhe që ne të jetojmë në këtë rrugë

.....

Mendoj se u kam kujtuar mjaft... Duhet të cenzurohem!

* * *



JU I SHTYNI NJERËZIT TË MENDOJNË DUHET TË CENZUROHENI

126

Falenderoj ALLAHUN që më dha jetë në një vend të Republikës së Atatyrkut, ku laicizmi vendosur dënohet në një masë.....Jam poashtu mirënjohës sepse nuk jetoj në një Shtet Fetar i vendosur mbi bazën e një botëkutimi arbitrar të <<sheriatit>>në vend të <<Din-it Islam >>. Prandaj, tash, mund të shkruaj dhe t'i shpreh mendimet e mija pa qenë i censuruar.

Jam po aq shumë mirënjohës, sepse kemi qindra e qindra dhe mijra e mijëra lexues që ndajnë mendimet tona, ndonëse <<Administrata për Çështjet Fetare >> në Turqi, nuk e lejon këtë, dhe se Fondacioni i Çështjeve Fetare ose bashkësitë e tyre ndalojnë shitjen e librave tonë nëpër panagjyret e organizuara të shitjes së librave, nën ndikimin e njohur të autoriteteve! Sidoqoftë, ne gjithnjë jemi fajtor! Sepse ne ndajmë një botëkuptim të ' ALLAHUT dhe të Din-it Islam të shprehur nga Njohësit e së Vërtetës, nga AHMED Jasevi deri tek Mevlana, nga Myhidin ibn AREBIU dhe Jonuz EMRE, nga

Haxhi BEKTASHI WALI tek Muhammed IKBALLI dhe ABDYLKADËR XHEJLANI e edhe shumë të tjerë.....

Sa i përket pikpamjes kur'anore që e zhvillojmë në librat tonë, ne i referohemi kryesisht Interpretimit kur'anor të Hamdi Jazir Elmali, i njohur me titullin "Hak Dini Kur'an Dili " që ishte botuar në turqisht nga Administrata për Çështje Fetare. Përveç tjerash, ne i referohemi shpjegimeve të të Dërguarit të ALLAHUT në faqen Web <<Kutub-i Sitte>>(gjashtë librat e hadithit) të njohura nga të gjithë, përfshirë edhe organizatën e sipërpërmendur.

127

Dëshira jonë është që njerëzit të mund të zbulojnë dhe t'a çmojnë <<Din-in Islam >>me dashuri e jo me urejtje, duke njohur gjithë të Vërtetën dhe urtësinë e tij, dhe jo me mosdije ose imitim (taklid)....Prandaj ne jemi fajtorë!

Shpresa jonë është që xhamitë të mos jenë më vende frikësuese(dekurajuese) ku dëgjohen fjalime skolastike, jologjike, të pakapshme dhe të varfëra (pa brumë), por të bëhen më shumë vendtakime për njerëzit tolerant(falës) për t'a ndarë njohjen dhe urtësinë, në një atmosferë dashurie dhe dhembshurie, ku do të ndahen shqetësimet dhe gëzimet. Në fakt xhamitë duhet duhet të jenë vende ku njerëzit do të gjenin paqe duke përmendur ALLAHUN.....

Ndani këto vende më shumë për ordinatorët, për libra se sa për zbukurime me çylyma dhe shandan luksuz.....

Bëjini qendra të thjeshta, më pak ipresionuese, por pajisni njerëzit me një njohje të dobishme, që t'ua hapni atyre horizontet e reja të të menduarit dhe t'ua lehtësoni të kuptuarit e <<Din-it Islam >>. Në këto xhami njerëzit do të do të duhej të gjenin rahatin e kërkesave të Din-it Islam, me një jetësim të vërtetë(taklid), largë prej imitimit. Ne shpresojmë

që këto vende të shenjta të mos shfrytëzohen për qëllime politike ose ekonomike. Prandaj ne jemi fajtorë!

Ne dëshirojmë që të mos keqpërdoret vullneti i mirë i njerëzve dhe që të hollat e tyre të mos vjedhen në mënyra të ndryshme, nga ata që duan t'i bindin se mëkatet e rahmetli prindërve të tyre mund të falen...>>Nuk do të duhej të keqpërdoren njerëzit dhe disa njerëz nuk do të duhej t'impunoheshin si udhëheqës fetar (autoritetet)që u shesin njerëzve këshilla, jo për tjetër, vetëm sa për të fituar të holla, aq sa kjo u bëhet e mundur, dhe po u ndërpre një ditë ky burim ata zhduken si mos të kishin qenë.

As Ahmed JASEVI, as MEVLANA Xhelaludin (Rumi), as i Dërguari ALLAHUT që ka përhapur dritën e tij në mbar botën, nuk kanë pranuar, çfardoqofte përfitimi material si kundërshpërblim për shërbimin e kryer, në mënyrë që <<Dini-Islam>> të kuptohet si duhet. Përkundrazi, i Dërguari i ALLAHUT ka shpenzuar tërë pasurinë e tij për këtë qëllim dhe është ndar nga kjo botë për në <<ahiret>> pa asgjë. Shumica e ithtarve të tij janë bërë

128

Shpërndarës e jo mbledhës fondesh n'emër të fesë.

<<Feja Islame>> vazhdon të përhapet dhe të bëhet e njohur përmes një çasjeje plot dashuri dhe kulturë (njohëse)nga SUFIJT e shquar gadi në të gjitha bashkësitë, që janë ndritë me SUFIZMIN(Tacavuf). Nga ana tjetër xhamitë janë plotë, mjerisht, plotë me të tillë që përpiqen t'i largojnë njerëzit nga predikuesit e njohjes së vërtetë. Autoritetet zyrtare përkrahin një turp të tillë.....

Si mundet Feja Islame të ketë çfardo lidhje me një botëkuptim ku të gjithë njerëzit hidhen ne Xhehenem, ose diskurset kundërshtojnë arsyen, logjikën, dhe shkencën. Ja që

për shkak të një botëkuptimi të tillë një e vejë e shkretë është dashur t'a paguaj zekatin për një byluzyk që e mbante, derisa aeroplanët dhe jahtat nuk i shtrohen zekatit!

Po...Mendimet e Ahmed HULUSIT u përhapën me shpejtësi të madhe ndër njerëzit, ndonëse ato ishin të rrezikshme!(po për kend të rrezikshme?)

Prandaj, sipas Administratës për Çështje Fetare, ne Fondacionin për Çështje Fetare dhe sipas disa Drejtuesve të kongregacionit, janë ndaluar gjithë librat e autorit të sipërpërmendur, si dhe audio dhe videokasetat e tij.

129

Po..., vërtetë duhet të ndalohen të gjitha këto, sepse ne i kemi shtyrë njerëzit të mendojnë!Ne u themi angazhoni mendjen tuaj, gjeni vet rrugën tuaj, dhe mos u bëni si dele!

Dhe... njerëzit që mendojnë, përparojnë si një toptë bore dhe vështrojnë njëmendësitë!

Ejani ! t'i hulumtojmë njëmendësitë, duke e vlerësuar Fenë Islame, me një botëkuptim të ri, në dritën e shkencës bashkohore. T'i lëmë anash meritë, urrejtjet, dallimet. Secili prej nesh le t'i nderoj të tjerët të tillë çfarë janë, t'i bashkojmë përpjekjet tona që t'a lehtësojmë jetën...Të përgatitemi së bashku, për jetën e pasvdekjes, përmes diturisë dhe dashurisë. Duajeni dhe nderoni këdo që t'a takoni duke ditur se ai ekziston në sajë të së Vërtetës (të Vërtetit)Hak. Mos ia theni zemrën tjetrit dhe mos u sillni jonjerëzishëm!

Pra, dëgjoni ose shikoni kasetat ose edhe lexoni librat e Ahmed HULUSIT, mbase me siguri do të ndalohen.....Përse dhe kush çka fiton prej kësaj?



FJALA IME E FUNDIT

130

Në këtë kapitull dëshiroj t'ua them këte lexuesve të mij të nderuar :

Përkundër gabimeve të panumërta dhe mangësive, megjithatë e kam ndërgjegjen e qetë, kur do të ndahem nga kjo botë, sepse jetën time këtu ia kushtova të kuptuarit t'ALLAHUT dhe në shërbim të Pejgamberit Muhammed! Insha'ALLAH do t'a kem vendin pranë të Dërguarit të ALLAHUT, në jetën e ardhshme(në ahiret), do të ndodhem Insha'ALLAH në shoqëri të atyre që kanë ndjekur rrugën e ALLAHUT dhe Pejgamberi TIJ!

Unë bëra ate që dita më së miri dhe si është më së miri për t'a ndar shkencën e ALLAHUT(ilmin) me njerëzit, nga ajo që më ishte dhënë mua, pa kurfar kundërshtpërblimi material. Përhapa njohjen (dijen) me sa mujta dhe nga ajo që m'u duk e drejtë! Siç kam thënë tashmë, nuk jam as hoxhë,, as ndonjë titullar tjetër shpirtëror! Elhamdyililah, nuk mbaj kurfar etikete fetare! Mjafton për mua të jem një lexues dhe një shkrimtar në kuptimin fizik dhe shpirtor, dhe s'di si t'a shprehë këtë mirënjohje dhe nder!

Bindja ime ka mbetur e pandryshuar : ju nuk mund të hasni çfardo ndryshimi në botëkuptimet e mija, perspektivat, ndijesitë, vështrimet, nepër shkrimet(veprat) e mija, që nga <<SHPALLJET>>, shkruar me 1966, kur isha 21 vjeç deri në <<UDHËTIMI NEPËR HËNË>>, shkruar ne moshën 51 vjeç.

Pohoj sërish, se nuk di t'a shprehë mirënjohjen time për këte!

Nëse ka gabime dhe mangësi në shkrimet e mija, kjo vjen nga të kuptuarit tim, e nëse ja kam qëlluar, ky është vendim i ALLAHUT dhe nga mëshira e bëmirsisë së TIJ!

Lexuesit e mij të nderuar!

131

Ruajuni imitimit dhe dirigjimit(mos lejoni të dirigjoheni)!Arsimohuni dhe drejtoni vet jetën tuaj!

Mos u bëni robë(medimesh, idesh të dikujt),mendoni dhe pranoni vetëm atë që ju duket e arsyeshme.

Lexoni veprat e Sufijve të njohur, pa dallim, dhe ata që i vlerësoni si<< evlia >> (të Shenjt) në historin Islame. Pastaj shtegtoni vet në shtegun tuaj.

“Mos haroni se janë të numërtë shtigjet që qojnë drejt(frymëzimit)t’ ALLAHUT, po aq të numërtë sa edhe shpirtrat”.

Dua të them se ju duhet t’a arrini ALLAHUN që ndodhet në vet qenësinë tuaj e jo një Zot larg vet jush, në mënyrë që t’ arrini t’u zbulohet plotësisht njëmendësia (realiteti)i tërë i vlerave të jetesës së XHENNETIT.

Drejtonju shenjetorëve të vërtetë pranoni lutjet dhe ndihmën e tyre morale(himmah), sepse lutjet e tyre dhe <<himaja>> e tyre janë të pranuar nga ALLAHU në këtë kuptimi << Ai flet përmes gjuhës tyre...>>

Ruajuni prej interesxhive materialitë!...

Feja jonë(Din-i ynë) mbështetet në <<pjesëmarje >>dhe(ndarje)e jo në dominim ose në qeverisje.

E jona është që ne t'a ndajmë njohjen me njerëzit!Pastaj ata janë të lirë t'a vlerësojnë ate sipas tyre, të jetojnë ashtu si ju duket se është më mirë dhe kështu ata ngarkohen vet me pasojat e jetës së pasvdekjes(për moskryerjen e mjaftueshme të obligimeve fetare)!

Miqtë e mi! Me aq sa dijmë ne, praktikat (ibadetet) si Namazi, agjërimi, Haxhi janë këshilluar në mënyrë që secili të përgatitet për jetën e pasvdekjes dhe t'i afrohem <<ALLAHUT>> që ndodhet në vet qenësinë tonë! Këto praktika nuk kanë të bëjnë fare me një Zot largë nesh.

132

Ja pse ju duhet t'i shfrytëzoni të gjitha rastet, të gjitha mjetet tuaja në këtë drejtim, me çdo kusht!

Ne kemi sjell më shumë hollësi në librin tonë të titulluar <MENDJA DHE BESIMI>>nëse ju dëshironi të lexoni më shumë.

Vëllezërit e mij! Shmang'juni dhe largojuni thashethemeve, përfoljeve, largohuni si prej gjërave më të frikshme të kësaj bote! Sipas të Dërguarit t'ALLAHUT nëse ju flisni përgojoni dikend(thoni ate që është), kjo është "gibet" përgojim! Lidhur me këtë Kur'ani-Kerim thotë :<<Ju hani mishin e vllait tuaj të vdekur>>!

Por nëse ju për personin e akuzuar thoni diçka për çka nuk keni dëshmi, kjo është "shpifje" (iftira)njëmijë herë më e rëndë se përgojimi!

Atëherë përfundojmë me këtë lutje shumë kuptimplote :

“ALLAHU im, të lutem siç TË është lutur, i dashuri YT Muhammed Mustafaja. Pranoje këtë lutje prej meje....ALLAHU im kërkoi mbështetjen Tënde dhe mbrojtjen TËNDE, nga gjithë ajo që TË është lutur i dashuri YT Muhammed Mustafa, më mbroj edhe moi!>>.

Me emër t’ALLAHUT përfundoj edhe përkthimi i librit dytë të mjeshtrit të pendes e të mendjes: AHMED HULUSI, <<ISLAMI>> Të kuptuarit ndryshe t’ISLAMIT!

Vlenë për të përmendur se të gjitha fjalët –shprehjet, plotësimet në kllapa janë të përkthyesit.

133

Lusim ALLAHUN xh.sh që përkthimi në shqip i veprave të HULUSIT të nderuar, të shërbej për një të kuptuar të mirrëfillt të <<ISLAMIT>>, nga një prizëm i ri, i kapshëm për mendjendriturit, por edhe për lexuesin e rëndomt të interesuar!

Ju uroj lexim të këndshëm lexues të nderuar!Mirepresim verejtjet dhe sygjerimet tuaja, rreth dy librave të përkthyer të autorit, ne faqen e tij tashme të njohur:www.ahmedbaki.com(në shqip).

Me respekt falenderoj duke qenë gjithnjë mirënjohëse prof.DR.MUHAMEDIN KULLASHI dhe intelektualit të ri, të zellshëm e të talentuar, për ndihmesën e tyre të pakursyer dhe ndërhyrjet e nevojshme në përkthim!

Lus ALLAHUN xh.sh. për shpërblimin e TIJ të pakufi!

Përkth.L.KULLASHI

TOULOUSE qershor 2004